

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Raport mbi qeverisjen në katër komunat me shumicë serbe: Graçanicë, Ranillug, Kllokot dhe Partesh

Korrik, 2012

“Letërnjoftimi i Komunave” është projekt i Institutit GAP i cili vlerëson qeverisjen komunale dy vite pas zgjedhjeve lokale të 2009. Ky projekt është implementuar në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Rezultatet e hulumtimeve të GAP për qeverisjen komunale janë debatuar me kryetarët e komunave në emisionet “Jeta në Kosovë”.

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	4
A. Letërnjoftimi i Komunës së Graçanicës 2012	7
A.1. Hyrje	7
A.2. Administrata komunale	8
A.3. Performanca buxhetore e Komunës së Graçanicës	9
A.4. Investimet kapitale	10
A.5. Aktivitetet e prokurimit publik 2010-2011	12
A.6. Arsimi dhe Shëndetësia	14
A.7. Transparenca	15
A.8. Përbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009	18
B. Letërnjoftimi i Komunës së Ranillugut 2012	21
B.1. Hyrje.....	21
B.2. Performanca buxhetore e Komunës së Ranillugut	21
B.3. Administrata e Komunës së Ranillugut	25
B.4. Investimet kapitale	26
B.5. Aktivitetet e prokurimit publik 2010-2011.....	27
B.6. Arsimi dhe Shëndetësia	28
B.7. Transparenca.....	28
B.8. Përbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009	30
C. Letërnjoftimi i Komunës së Kllokotit 2012	32
C.1. Hyrje.....	32
C.2. Performanca buxhetore e Komunës së Kllokotit	32
C.3. Administrata në komunën e Kllokotit	33
C.4. Investimet kapitale.....	35
C.5. Aktivitetet e prokurimit publik 2010-2011	36
C.6. Arsimi dhe Shëndetësia.....	41
C.7. Transparenca.....	42
C.8. Ecuria e përbushjes se premtimeve të fushatës zgjedhore 2009	43
D. Letërnjoftimi i Komunës së Parteshit 2012	42
D.1. Hyrje	42
D.2. Performanca buxhetore e Komunës së Parteshit.....	42
D.3. Investimet kapitale	43
D.4. Aktivitetet e prokurimit publik 2010-2011	45
D.5. Administra në Komunën e Parteshit.....	46
D.6. Arsimi dhe Shëndetësia	46

D.7. Trasparenca	50
Burimet	49

Përmbledhje ekzekutive

Komuna e Graçanicës, Parteshit, Ranillugut dhe Klllokotit janë formuar si institucione në nivel të qeverisjes lokale nga procesi i decentralizimit, i bazuar në Dokumentin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit Final të Kosovës ("Pako e Ahtisaarit"). Këto komuna kanë nisur së funksionuari që nga janari 2010. Zgjedhjet e para lokale për zgjedhjen e kryetarit të komunës dhe përfaqësuesve në kuvendet komunale u mbajtën në nëntor 2009 (Graçanic, Raniluk dhe Klllokot) dhe në qershor 2010 (Partesh). Tani, këto katër komuna kanë hyrë në vitin e tretë të funksionimit. Ky raport i Institutit për Studime të Avancuara GAP vlerëson funksionimin e këtyre katër komunave të reja. Raporti vlerëson gjendjen e qeverisjes komunale në periudhën Janar 2010 – Qershor 2012.

Pasqyra e të arriturave në komunat e reja të Kosovës, përkatesisht në atë të Graçanicës, Ranillugut, Klllokotit dhe Parteshit, nuk është e njëjtë për të katër këto komuna. Shkalla e të arriturave, por edhe mënyra e menaxhimit apo qeverisjes, dallon esencialisht në mes Komunës së Graçanicës dhe tri komunave tjera. Komuna e Ranillugut, Klllokotit dhe Parteshit gjenden pothuajese në të njëjtën pikë për sa i takon zhvillimit, shkallës së investimeve, menyrës së shpenzimit të parasë publike, performances në administratë, nivelit të transparencës, etj.

Komuna e Graçanicës për më pak se dy vite ka arritur t'i rrisë të hyrat komunale për mbi 1 milion euro dhe të hyrat vetanake pritet të shënojnë rritje edhe në vitet në vazhdim. Kjo nuk ka ndodhur me tri komunat tjera, madje këto komuna më shumë kanë shpezime në telefon, dreka dhe karburante, se sa që arrijnë të gjenerojnë të hyra vetanake. Kjo duhet të ndryshoj, ngase në të kundërtën, tri komunat e lartëcekura do të mbeten për kohë të gjatë barrë e buxhetit qendror dhe do të kenë vështiresi serioze në funksionimin efikas të tyre.

Qeveria e Kosovës ka dedikuar miliona euro në projekte të ndryshme në këto katër komuna dhe GAP ka evidentuar raste kur paratë e dhëna dhe të shpenzuara në projekte nuk e kanë pasur efektin e duhur. Kjo do të duhet t'i shtyjë institucionet e nivelit qendror që krahas dhënies së parave për projekte të rritet edhe shkalla e monitorimit dhe vlerësimit të performancës së shpenzimit të parasë publike dhe menyrës së implementimit të projekteve për të cilat ofrohen paratë.

Komuna e Graçanicës sipas vlerësimeve të bëra nga Instituti GAP, rezultojnë të jetë komunë e konsoliduar, efikase dhe brenda dikastereve të saj ekziston diciplina, përgjegjësia, llogaridhënia. Po ashtu kjo komunë ka shënuar rezultate evidente në zgjidhjen e problemeve esenciale me të cilat është përballur ky lokalitet.

Kjo nuk mund të thuhet edhe për Ranillugun, Klllokotin dhe Parteshin. Komuna e Parteshit, akoma nuk është konsoliduar në tërësi, i mungojnë shumë organe qeverisëse

dhe shumë vendime apo norma juridike komunale mbi bazë të cilave do të mund të rriste shkallën e angazhimit dhe rrjedhimisht edhe nivelin e rezultateve. E vetmja fushë ku kjo komunë ka shënuar rezultate të mira është ajo e ofrimit të shërbimeve për qytetarëve nga zyra e ofiqarisë (certifikata të lindjes, martesës, vendbanimit). Gjendje përafersisht e njejtë me këtë mbizotëron edhe në komunën e Kllokotit dhe asaj të Ranillugut.

Autoritetet lokale në Ranillug, Partesh dhe Kllokot, do të duhet të aplikojnë masa rigorozë për sa i takon respektimit të normave institucionale. Përgjithësisht në këto komuna mungon diciplina, përgjegjësia, llogaridhënia dhe ka një shkallë tejet të ulët të kujdesit ndaj aseteve dhe parasë publike.

Njëkohësisht forimimi i Komunave të reja në Graçanicë, Ranillug, Kllokot dhe Partesh nuk ka arritur t'i neutralizoj strukturat paralele të kontrolluara dhe financuara nga Qeveria e Serbisë, struktura të cilat në menyrë paralele ofrojnë shërbime administrative dhe teknike qytetarëve në këto lokalitete. I tërë sistemi shëndetësor dhe arsimor në këto katër komuna kontrollohet nga ana e strukturave paralele dhe nuk janë të pakta rastet kur të njejtat struktura involvohen edhe në fushat tjera të jetës publike. Krejt kjo e bënë edhe më të mjegullt gjendjen në këto lokalitete. Autoritetet komunale në Graçanicë, Ranillug, Kllokot dhe Partesh në vazhdimësi kanë investuar në objektet arsimore dhe shëndetësore të cilat direkt dhe në tërësi kontrollohen nga strukturat e menaxhuara nga Beogradi, madje pjesa më e madhe e stafit lokal që punon në këto qendra arsimore dhe shëndetësore, pranon paga edhe nga institucionet e Kosovës edhe nga institucionet e Serbisë. Por, planprogrami në shkolla dhe platforma e menaxhimit në shëndetësi është e ndërtuar nga strukturat paralele dhe jo nga institucionet komunale të Kosovës.

Autoritetet lokale në këto katër komuna janë ndjer dhe vazhdojnë të ndihen të pafuqishme kundruall strukturave paralele dhe mbetet shqëtesues fakti se në shumë raste kur janë përballur organet komunale kosovare me strukturat paralele, janë zbrapsur organet komunale dhe jo strukturat paralele. Kjo më së miri ilustron në Komunën e Parteshit e cila objektin e ka në Pasjan, ndërsa në Partesh gjendet objekti i strukturave paralele. E njëjta ndodh edhe me Komunën e Ranillugut, e cila në pamundësi për të shfrytëzuar objektet në Ranillug, ka improvizuar objektet komunale në Ropotovë të Madhe dhe Domarocv.

Shumica e raporteve periodike të institucioneve qendrore nuk përmbajnë të dhëna për vlerësimin e gjendjes qeverisëse në këto katër komuna. Përfundimisht bënë vetëm Ministria e Financave, e cila në raportet buxhetore përfshin edhe të dhënat nga këto katër komuna me shumicë serbe.

Një mangësi e dukshme është e hasur në terren, veçmas në Komunën e Ranillugut, Parteshit dhe Kllokotit, është mungesa e pronës komunale apo publike. Pjesa më e madhe e tokës është private dhe një pjesë është shoqërore, e cila menaxhohet nga Agjencia

Kosovare e Privatizimit (AKP). Qeveria e Kosovës do të duhet të shikoj mundësinë që përmes AKP të gjej zgjidhje të përshtatshme, meqë rast prona shoqërore të kalohet në pronë komunale, tokë e cila pastaj do të shërbente për investime publike, si për çerdhe, shkolla, punkte shëndetësore, shtëpi të kulturës, etj.

Shkalla e lartë e shpenzimit të buxhetit në linjat e “mallrave dhe shërbimeve”, veçmas në Komunën e Ranillikut, Parteshit dhe Kllokotit, vije edhe si rezultat i mungesës së mbikëqyrjes dhe monitorimit, qoftë nga institucionet shtetërore, apo edhe nga mediat dhe shoqëria civile.

Komuna e Kllokotit dhe Parteshit kanë mangësi të mëdha në përpilimin e raporteve financiare. Raportet financiare të këtyre dy komunave janë në formë narrative dhe jo në tabela llogaritëse. Si rrjedhojë është e vështirë të kuptohen këto raporte dhe janë me plotë mangësi.

Niveli i përgjithshëm i transparencës në këto komuna mbetet larg standardeve të kërkuara. Nëse fokusohemi në faqet zyrtare të këtyre institucioneve, përgjithësisht nuk mund të hasen raportet financiare, veçmas jo ato që lidhen me shpenzimet. Faqet zyrtare kryesisht përdoren për transmetimin e agjendave të kryetarit.

Instituti GAP ka evidentuar dhe vlerësuar zhvillimet e përgjithshme në këto komuna në dy vitet e fundit. GAP ka evidentuar dhe numëruar problemet, mangësitë dhe vështirësitë, duke bërë një lidhshmëri pasqyrimesh nga fusha e investimeve kapitale, mënyra e shfrytëzimit dhe shpenzimit të parëse publike, funksionimi i administratës dhe ekzekutivit dhe, po ashtu, janë vlerësuar ndaras të gjitha premtimet e dhëna nga kryetarët e këtyre komunave dhe shkalla apo ecuria e realizimit të tyre.

A. Letërnjoftimi i Komunës së Graçanicës 2012

A.1. Hyrje

Komuna e Graçanicës shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës. Komuna e Graçanicës përbëhet nga 16 zona kadastrale me një sipërfaqe prej 131.25 km katrorë, ku jetojnë 19.400 banorë, prej tyre 16.972 serbë (85.7%), 1.689 shqiptarë (3.7%), dhe 10.6% e përbejnë pakicat tjera (Rom, Ashkali, Egjiptas).¹

Komuna e Graçanicës është formuar si njësi e re komunale, duke i shkëputur territor Komunës së Prishtinës, Lipjanit dhe Fushë Kosovës. Me qëllim të funksionalizimit të organeve të Komunës së Graçanicës dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarë, në muajin shkurt të vitit 2010 është nënshkruar marrëveshja e mirëkuptimit mes kësaj komune dhe tri komunave të lartëcekura, marrëveshje e cila ka precizuar dhe saktësuar mënyrën dhe dokumentacionin që duhet të bartet nga komunat amë në Komunën e Graçanicës, si: dokumentacioni i gjendjes civile, tatimit në pronë, urbanizmit dhe kadastrit, si dhe specifikimet në lidhje me lejet e ndërtimeve. Komuna e Prishtinës ka bartë 874 dokumente me rëndësi për pronën dhe kadastrin, rreth 4 mijë për gjendjen civile dhe po ashtu janë bartur edhe 74 lëndë që kanë pasur të bëjnë me lejet e ndërtimit dhe sferën e ndërtimeve në përgjithësi. Komuna e Lipjanit i ka ofruar Graçanicës 1.927 prona apo zona kadastrale. Zonat e Lipjanit që tani janë nën administrimin e Komunës së Graçanicës janë Dobratini, Gushterica, Livagje, Suhadoll, Skullan dhe Radeve.

Kryetar i Komunës së Graçanicës është Bojan Stojanović, anëtar i partisë “Partia e Pavarur Liberale” (SLS), parti kjo që ka fituar mbi 60% të votave në zgjedhjet e mbajtura në nëntor 2009. Kuvendi Komunal i Graçanicës përbëhet prej 19 këshilltarëve komunal, 12 prej të cilëve vijnë nga subjekti politik nga vije edhe Kryetari i Komunës. Subjekti i dytë me i madh i përfaqësuar në Kuvendin e Graçanicës është “Lëvizja Serbe për Rezistencë” me dy këshilltar, lëvizja “Vidovdan” me dy këshilltar, dhe me nga një përfaqësues në Kuvend të Graçanicës janë të përfaqësuara Partia Demokratike Serbe për Kosovën dhe Metohinë, Partia Serbe për Kosovën dhe Metohinë. Në Kuvend të Graçanicës është e përfaqësuar edhe një parti shqiptare (Lidhja Demokratike e Dardanisë-LDD) me një përfaqësues, i cili njëherazi është edhe nënkryetar i Komunës, pozitë kjo të cilën e ka marr duke ju referuar dispozitave të Ligjit për vetëqeverisje

¹ OSCE. Municipal Profiles (Profilet e Komunave). Nëntor, 2011. Burimi: <http://www.osce.org/kosovo/88762>

lokale, ku parashihet që nënkryetari i dytë duhet të jetë përfaqësuesi i komunitetit më të madhe në atë komunë.²

Komuna e Graçanicës etnikesh është e përzier, vendbanimet (fshatrat) me popullatë më të madhe shqiptare janë Kishnica dhe Shushica. Investimet në këto lokalitete kanë qenë shumëanshme dhe në asnjë rast nuk është vërejtur ndonjë përjashtim apo diskriminim mbi baza etnike.

A.2. Administrata komunale

Administrata e Komunës së Graçanicës përbehet nga gjithsej 79 të punësuarve. Pa përfshirë këtu të punësuarit në sektorin e shëndetësisë dhe arsimit. Me këto dy sektorët e fundit numri total i të punësuarve në Komunën e Graçanicës është 417. Në 2010 numri i të punësuarve ka qenë 358, apo 59 të punësuar më pak. Numri më i madh i të punësuarve janë në fushën e shëndetësisë primare, pastaj vije fusha e arsimit. Nga dikasteret brenda komunës hasen disa drejtori të cilat kanë në dispozicion numër më të madh të punësuarve në krahasim me drejtorit tjera që kanë shtrirje më të gjerë të kompetencave. Kësisoj Drejtoria e Kulturës ka gjithsej 9 të punësuarve, përderisa Drejtoria e Inspektionit ka vetëm 5 të punësuar.

Tab. nr.1: Numri i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratën komunale të Graçanicës

Sektorët	Numri i të punësuarve
Zyra e Kryetarit	5
Drejtoria e Administratës	21
Drejtoria e Inspektionit	5
Drejtoria e Financave	8
Drejtoria e Bujqësisë	7
Drejtoria e Gjeodezisë	7
Drejtoria e Kulturës	9
Sektorët/ zyrët/ departamentet	18
Spektori i Arsimit/ para fillor/ fillor dhe i mesëm	117
Spektori i Shëndetësisë	220
Gjithsejt	417

² Ligji për vetëqeverisje lokale në Kosovë, neni 61.1.

A.3. Performanca buxhetore e Komunës së Graçanicës

Komuna e Graçanicës ka shënuar rritje progresive në fushën e të hyrave vetanake. Kësisoj ky institucion gjatë vitit 2010 ka regjistruar të hyra në vlerë prej afro 335.000 euro, përderisa një vit me vonë niveli i të hyrave ka qenë mbi 1.1 milionë euro. Shuma totale e buxhetit të Komunës së Graçanicës gjatë 2011 ka qenë 4.538.780 euro, ndërsa për 2012 buxheti i kësaj komune është shuma e plotë. Ky nivel i buxhetit e bën Komunën e Graçanicës një nga komunat me buxhetin më të madh, në krahasim me territorin dhe nurmin e popullsisë. Ndonëse komunë e re, Komuna e Graçanicës për nga niveli i buxhetit mund të krahasohet me komunat si Fushë Kosova, Shtimia, Deçani, Klina, Kaçaniku, të cilat kanë përafërsisht buxhet sa Komuna e Graçanicës. Këtë buxhet të lartë komuna e Graçanicës e siguron falë edhe pozitës së saj, e cila ndodhet në një hapësirë ku ushtrohet një aktivitet i lartë ekonomik, sidomos në fushën e ndërtimeve.

Rritja e të hyrave buxhetore vlerësohet të ketë ardhur si rezultat i një qasje serioze dhe rigoroze që kanë treguar autoritetet e Graçanicës në vjeljen e të ardhurave dhe po ashtu ndikim të madh ka pasur ndjekja e një qasje fleksibile, ngase përgjegjësit e Komunës së Graçanicës para se të hartohet rregullorja komunale për ngarkesa, gjoha dhe tarifa kanë analizuar dhe konsultuar subjektet dhe bizneset e ndryshme duke vënë norma të pranueshme për të dyja palët, përkatësisht për komunën dhe qytetarët apo bizneset.

Aktualisht tri janë sferat nga ku komuna realizon më së shumti të hyra: nga lejet e ndërtimit, nga shfrytëzimi i hapësirës publike, prej bizneseve dhe subjekteve tjera si dhe nga tatimi në pronë. Kjo e fundit e përbën 45% të të hyrave të përgjithshme.

Edhe në Komunën e Graçanicës është e shfaqur praktika e bartjes së mjeteve nge një vit në tjetrin. Kësisoj Komuna e Graçanicës nga vitit 2010 në vitin 2011 ka bartur rreth 500.000 euro. Bartja e këtyre mjeteve nënkupton edhe bartjen e prioriteteve dhe projekteve nga një vit në tjetrin dhe e gjithë kjo krijon problem, ngase rritet numri i projekteve investuese dhe zvogëlohet shkalla e monitorimit dhe vlerësimit të punëve nga ana e autoriteteve lokale.

Performanca buxhetore e Komunës së Graçanicës shikuar nga të gjeturat e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) i cili i referohet vitit 2010 ka evidentuar raste kur janë bërë pranime të mallit dhe pagesa pa pasur kontroll të duhur dhe pa u plotësuar procedurat e nevojshme. Kësisoj ZAP-i ka gjetur në tetë raste pranim të mallit nga ana e Komunës së Graçanicës pa u nënshkruar faturat e pranimit, gjë kjo e cila sipas Auditorit lë hapësirë për dyshime në sasinë dhe formën e mallit të pranuar nga komuna në linjën e buxhetit për mallra dhe shërbime.

Po ashtu sipas Auditorit të Përgjithshëm lëshimet në Komunë të Graçanicës janë thelbësore në mbajtjen e regjistrave nga Zyra e Prokurimit. Komuna nuk ka plan për ecurinë e punës në zyrën e prokurimit, nuk mban listë për prokurimet e kryera si dhe

mangësi kryesore paraqet mungesa e dokumentacionit mbi prokurimet e kryera nga ana e Komunës së Graçanicës.

Sipas Auditorit faturimi i derivateve të naftës në Komunën e Graçanicës kryhet në baza mujore, por faturave nuk u janë bashkangjitur fletë dërgesat mbi pranimin e derivateve me qëllim të përcaktimit të sasisë të faturuar dhe asaj të dorëzuar. Kjo e bën të paqartë faktin nëse sasi të e faturuara realisht edhe janë ato të pranuar. Po ashtu Auditorit nuk ka arritur të gjej te dhëna te cilat tregojë për lëvizjet e automjeteve zyrtare të komunës, ngase komuna nuk mban një regjistër të tillë.

Auditori i Përgjithshëm në raportin e fundit (2011) i cili i referohet vitit 2011 vlerëson se të hyrat komunale në Graçanicë nuk janë harmonizuar mes drejtorive dhe sektorit të financave. Po ashtu, sipas këtij raporti, komuna nuk ka regjistra të plota dhe të sakta në lidhje me borxhlinjtë e komunës.

Për sa i takon shpenzimeve të reprezentacionit dhe shpenzimeve të përafërta në Komunën e Graçanicës është hasur një rritje e ndjeshme e këtyre shpenzimeve në disa kategori, krahasuar mes viteve 2010 dhe 2011.

Tab. nr.2: Shpenzimet për disa kategori të mallrave dhe shërbimeve

Shpenzimet për:	2010	2011
Udhëtime brenda dhe jashtë vendit	9.220	8.112
Shpenzime të telefonit	12.580	21.489
Për derivate	28.660	35.613
Për marketing	26.190	9.825
Shpenzimet e reprezentacionit	21.920	18.623

A.4. Investimet kapitale

Investimet ne infrastrukturën e Komunës së Graçanicës janë të shumëanshme dhe ato mund të vërehen në të gjitha pjesët e qytetit. Dinamika dhe cilësia e punëve të kryera në këtë lokalitet është dukshëm me e lartë dhe ekonomikisht më e favorshme se sa në shumë komuna tjera të Kosovës.

Investimet pasqyrohen me një gërshetim projektesh dhe në përgjithësi në të gjitha rastet investimet bëhen duke ekzistuar paraprakisht një plan i detajuar ku parashihen edhe elementet me të vogla të dukjes së projektit final. Shembull për këtë është rregullimi i shtratit të lumit të qytetit, ku përveç rregullimit të shtratit është paraparë ndriçimi adekuat për lumin, ndriçimi për hapësirat e këmbësoreve përgjatë rrjedhjes së lumit dhe po ashtu janë krijuar shtigje gjelbërimi dhe ulëse për qytetarët. Po ashtu autoritetet lokale nuk kanë lejuar që lokalet afariste apo hoteliere të ndërtohen përgjatë rrjedhjes së

lumit me arsyetimin se kjo prish imazhin e qytetit dhe njëherazi lokalet shkaktojnë zhurmë e cila ndikon negativisht tek pushuesit ne ulëset përgjatë lumit. Të vetmet shërbime hoteliere të lejuara përgjatë rrjedhjes se lumit janë ato të tipit të hapur të cilat janë të obliguara të lëshojnë muzikë të lehte dhe atë me zë të ulet.

Përgjithësisht rrugët e qytetit dhe të fshatrave përreth janë asfaltuar dhe rregulluar. Po ashtu në të gjitha zonat e qytetit duke përfshi edhe fshatrat janë ndërtuar kopshte për fëmijë si dhe qendra rekreative – sportive për të rinjë.

Rrjedha e përgjithshme e investimeve kapitale në Komunën e Graçanicës ka qenë progresive dhe kjo rrjedhë është vërejtur edhe në gjashtë mujorin e parë të 2012. Investimet që kanë filluar këtë vit (2012) në sferën e infrastrukturës janë ndërtimi i infrastrukturës për Kompleksin Sportiv në Brnjesh, ndërtimi i kolektorit të ujërave të zeza në fshatin Radevo, ndërtimi i rrugës Llapnasellë-Çagllavicë, rikonstruimi i rrugës tek varrezat e Shushicës, rregullimi i shtratit të lumit në Preocë, sanimi i kanalizimit ne fshatin Dobrati.

Shpërndarja e investimeve kapitale, të cilat në Komunë të Graçanicës kapin vlerën e afro 1.5 milionë eurove, përfshin kryesisht rregullimin e infrastrukturës rrugore, por investime të ndjeshme ka pasur edhe në sistemin arsimor, shëndetësor, dhe në krijimin e qendrave rekreative – sportive.

Tab. nr.3: Investimet kapitale në Komunën e Graçanicës

Projektet kryesore të realizuara gjatë 2010 -2011	Vlera (Euro)
Rregullimi i lumit dhe ndërtimi i impiantit	48.998
Ndërtimi i rrethojës dhe kullës se Livagjes	47.616
Ndërtimi i Ambullantës në Dobrotin	56.916
Rregullimi i shtratit të lumit në Llapnasellë – Faza II	49.820
Rregullimi i shtratit të lumit Zhegova në Dobrotin	43.750
Rregullimi i shtratit të lumit dhe ndërtimi i kolektorit fekale në Llapnasellë – Faza I	112.563
Ndërtimi i shkollës në Sushic	92.098
Rekonstruimi dhe rregullimi i parkut ne qendër te Graçanicës	67.000
Ndërtimi i qendrës zejtare në Gushtericë të Poshtme	229.444
Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit fekal në Kishnicë	24.714
Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit atmosferik ne qendër	36.975
Ndërtimi i Parkut ne Gushtericë te Ulët	18.207
Rregullimi i rrugës Kryesore ne Gracanice Faza III	114.745
Rekonstruimi i Terenit te Basketbollit dhe Volejbollit ne Brnjesu	29.206

Ndërtimi i Spitalit ne Gracanicë - Objekti D dy faza)	310.000
Ndërtimi i Qendrës tregtare në Graçanicë	423.743
Ndërtimi i dy terreneve sportive ne Kishnic	26.452
Ndërtimi i Kompleksit Sportiv ne Gracanicë	23.677
Ndërtimi i sheshit në Dobratin	10.350

Shkalla e realizimit të investimeve kapitale në Graçanicë gradualisht po kalon nga faza e investimeve esenciale (rrugë, objekte arsimore dhe shëndetësore, etj.) në fazën e investimeve më të avancuara (parqe, qendra rekreative, etj.). Gjatë tri viteve të ekzistencës së kësaj komune vërehen përmirësime serioze në rrugët e qytetit, parqet, objektet komunale të arsimit dhe shëndetësisë, në zgjerimin dhe instalimin e ndriçimit publik dhe po ashtu pothuajse në të gjitha lokalitetet e komunës janë ndërtuar fusha sporti e rekreacioni.

Autoritetet komunale kanë shënuar rezultate pozitive edhe sa i takon mirëmbajtjes së hapësirave të rregulluara. Parqet e ndërtuara së bashku me shtratin e lumit të qytetit janë mirëmbajtur në vazhdimësi dhe nuk janë hasur dëmtime në shkallë të madhe në këto projekte të investuara. Dëmtimet më të mëdha janë hasur në projektin për ndërtimin e anësoreve të trotuareve, ku pjesa dërrmuese e tyre janë thyer apo larguar nga qytetarët dhe përgjegjësit e lokaleve afariste të cilët kanë synuar të ju krijojnë hapësirë parkingu veturave përpara lokaleve, shtëpive apo bizneseve të tyre.

Ekzekutivi i Komunës së Graçanicës ka lejuar që përgjatë magjistrales Prishtinë - Graçanicë të ndërrohet karakteri i tokës nga ajo bujqësore në atë ndërtimore. Kjo është shtruar disa herë radhazi në Kuvendin e kësaj komune si shqetësim nga ana e asamblistëve, por ekzekutivi nuk ka ndryshuar qasje në këtë drejtim.

A.5. Aktivitetet e prokurimit publik 2010-2011

Njësia e Prokurimit në Komunën e Graçanicës, sipas organogramit të administratës së komunës, funksionon në kuadër të Drejtorisë së Administratës. Ndonëse Komuna është me përbërje etnike shumicë serbe, shefi i prokurimit është shqiptar. Për dy vite (2010-2011) Komuna e Graçanicës ka lidhur nëpërmjet procedurave të prokurimit 268 kontrata në vlerë të përgjithshme afro 8.3 milionë euro. Janë disa raste kur procedurat e prokurimit janë kryer nga ana e Komunës së Graçanicës, ndërsa paratë kanë qenë të dedikuara për projekte të caktuar nga ana e institucioneve qendrore të Kosovës.

Tab. nr.4: Kontratat e Prokurimit në Komunën Graçanices
2010-2011

Viti	Nr. i kontratave	Vlera e kontratave (Euro)
2010	115	4.916.274.19
2011	153	3.356.840.42
Totali	268	8.273.114.61

Burimi: KRPP Raporti për 2010 dhe 2011

Të gjitha kontratat në 2011 janë dhënë kompanive të cilat kanë ofruar çmimin më të ulët dhe asnjë kontratë nuk është lidhur në bazë të kriterit “tenderi ekonomikisht më i favorshëm.”

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) ka gjobitur Komunën e Graçanicës me 6 mijë euro për shkeljet në rregullat e prokurimit publik që kanë pasur të bëjnë me tenderin për “furnizim dhe montim me kamera për monitorim të rrugëve të Graçanicës”. Gjobitja nga OSHP ka ardhur ngase autoriteti i Graçanicës ka shpërfillur rekomandimet e OSHP-së për ritenderim të linjës “furnizim dhe montim me kamera për monitorim të rrugëve të Graçanicës”. Kjo sjellje e udhëheqësve të Komunës së Graçanicës nuk përkon me parimet e qeverisjes së mirë, ngase institucion përgjegjës dhe kompetent për të vlerësuar rregullsinë e procedurave të një tenderi është OSHP-ja dhe kështu secili vendim që merr ky institucion do të duhet të manifestohet me zbatueshmëri të plotë nga institucionet tjera, kjo nuk ka ngjarë këtë rast me Komunën e Graçanices e cila edhe pasi OSHP-ja ka kërkuar anulimin dhe ripërsëritjen e tenderit për furnizimin dhe montimin e kamerave për rrugët e qytetit, Komuna e Graçanicës e ka shpërfillur vendimin e OSHP-së duke implementuar në tërësi nismën e saj tenderuese.

Komuna e Graçanicës në mars 2012 i ka lëshuar hapësirën komunale (objekt komunal) për dislokimin e Radios “Graçanica”. Kjo është bërë pa pasur ndonjë kontratë për shfrytëzim dhe pa pasur ndonjë kompensim adekuat në lidhje me lëshimin e hapësirën publike në shfrytëzim. Deputeti i Kuvendin Komunal të Graçanices Agim Krasniqi ka kërkuar në mbledhjen e Kuvendit Komunal (mars 2012) sqarime nga ekzekutivi në lidhje me këtë. Ky hap i Komunës bëhet në kohën kur akoma komuna është e sistemuar në një objekt privat me qira të cilin për çdo muaj e paguan nga 3.300 euro.

Komuna e Graçanicës me datë 16.09.2011 ka nënshkruar kontratë me kompaninë “Tekno-ing Consulting” për ndërtimin e një objekti për nevojat e Radio Graçanicës. Kontrata ka pasur vlerën e investimeve në shumën prej 143.666,15 euro. Ndërtimi i këtij objekti bëhet edhe për qellim që radion të shndërrohet edhe në televizion lokal për Graçanicën. Komunitat nuk kanë në pronësi të tyre media lokale elektronike. Andaj, një investim kaq i madh i Komunës së Graçanicës për një media lokale private është absurd dhe nuk do të duhej të ndodhte.

Komunës së Graçanicës furnizimi i qendrave mjekësore me pajisje elementare mjekësore për çdo vit i kushton afro 60.000 euro. Tenderi i fundit i dhënë për këtë qëllim është ai i datës 06.12.2011 të cilin e ka fituar firma nga Prishtina "Eramed" në vlerë të kontratës 56.990 euro. Sistemi shëndetësor në Graçanicë nuk është nën autoritetet e Komunës, por direkt ky sistem kontrollohet dhe menaxhohet nga struktura paralele të cilat financohen nga Qeveria e Serbisë. E njëjta firmë "Eramed" me datë 22.11.2011 ka fituar tenderin tjetër për furnizim të qendrave mjekësore me material shpenzues me vlerë të kontratës prej 45.998 euro.

Në total, në 2011 Komuna e Graçanicës ka ndarë 428.432 euro për servisim të veturave, përmes tre tenderëve të ndryshëm (2011). Për servisimin e veturave Shkoda Komuna e Graçanicës ka dhënë tender në vlerë prej 6.938 eurove. Kontrata është lidhur me datë 04.10.2011 me kompaninë "Bosch" nga Fushë Kosova. Ndërkaq për servisimin dhe mirëmbajtjen e veturave tjera, Komuna e Graçanicës ka lidhur kontratë përmes procedurave të prokurimit në vlerë prej 242.091 euro. Kontrata është lidhur me datë 23.09.2011 me kompaninë "Cile Auto" me seli në Llapnasellë. Po ashtu për servisimin dhe mirëmbajtjen e veturave të tipit Hondai dhe Shkoda Komuna e Graçanicës po në vitin 2011 ka lidhur kontratë me kompaninë "Hondai" në vlerë prej 179.403 euro. Kontrata është lidhur me datë 19.07.2011.

A.6. Arsimi dhe Shëndetësia

Sistemi shëndetësor dhe arsimor në Graçanicë funksionon ndaras nga autoritetet zyrtare komunale të

Komunës së Graçanicës. Përgjegjësit e këtyre qendrave nuk i japin përgjegjësi Komunës, por strukturave paralele të cilat menaxhohen dhe financohen direkt nga Qeveria e Serbisë. Pjesa dërrmuese e stafit në këto qendra pranojnë rrogën edhe nga Komuna e Graçanicës dhe njëherazi rrogë marrin edhe nga Beogradi. Përpjekjet e Komunës së Graçanicës për t'i përfshi këto qendra në sistem të Kosovës nuk kanë qenë rigorozë me arsyetimin se kjo është një çështje politike e cila nuk mund të zgjidhet nga ana e autoriteteve lokale. Në asnjë raport të nivelit qendror (MASHT dhe MSH) nuk mund të hasen shifra për numrin e të punësuarve në sistemin arsimor dhe shëndetësor në Graçanicë me arsyetimin se këto qendra nuk raportojnë tek institucionet e Kosovës.

Edhe përkundër kësaj Komuna e Graçanicës në vazhdimësi ka investuar në këto qendra, madje ka paraparë buxhet edhe në linjën e mallrave dhe shërbimeve. Rrjedhimisht, Komuna e Graçanicës shpenzon para për rrymën, ujën, mbeturinat dhe shpenzimet e tjera operative për qendrat e mjekësisë dhe objektet arsimore në Graçanicë, ndonëse nuk janë nën autoritetin e saj.

Qeveria e Kosovës së bashku me Komunën e Graçanicës kanë nisur së ndërtuari një spital tek vendi i quajtur Badovci dhe vlera e tij është afro 2 milionë euro. Autoritetet lokale të Graçanicës janë shprehur optimist që hapja e këtij spitali do t'i neutralizoj strukturat paralele në shëndetësi dhe njëherazi ata kanë premtuar që spitali i ri do të punoj sipas normave ligjore të vendit.

Sipas një raporti të OSBE-së të publikuar në nëntor të vitit 2009 sistemi arsimor në Graçanicë përbehet nga katër çerdhe, apo institucione para shkollore, me gjithsej 850 fëmijë, pastaj ekzistojnë 8 shkolla fillore me gjithsej 2.237 nxënës dhe 204 mësues dhe 8 shkolla të mesme me 1.549 nxënës dhe 310 mësues.³ E vetmja shkollë në Graçanicë e cila punon sipas plan programeve të MASHT është ajo në fshatin Kishnicë e cila banohet kryesisht nga shqiptarët.

A.7. Transparenca

Komuna e Graçanicës mbulohet nga dy radio lokale (Radio Graçanica dhe Radio Kim) të cilat pasqyrojnë zhvillimet e përgjithshme komunale. Sipas tyre, bashkëpunimi është në nivelin e kënaqshëm dhe nuk ekzistojnë raste kur zyrtarët komunal kanë hezitur apo kundërshtuar paraqitjen e tyre në opinion nëpërmjet këtyre radiove. Uebfaqja e Komunës së Graçanicës nuk përmban informacionet dhe materialet e nevojshme rreth aktiviteteve dhe performancës së Komunës. Në uebfaqe nuk publikohen raportet mbi shpenzimet e parasë publike. Brenda komunës funksionon edhe Zyra për Informim ku në raportet e deritanishme vjetore nuk është shkruar asnjë paragraf për këtë zyre për të treguar apo paraqitur shkallën e punës, formën e përfshirjes në pasqyrimin e aktiviteteve komunale dhe aspektet tjera të përgjithshme.

Po ashtu të gjitha informatat në faqen zyrtare mund të gjenden vetëm në gjuhën serbe, jo edhe në gjuhët tjera. Komun e Graçanicës nuk e shfrytëzon uebfaqen zyrtare e cila menaxhohet nga Ministria e Pushtetit Lokal (<http://kk.rks-gov.net/gracanice/>), por ka hapur një uebfaqe tjetër www.opstina-gracanica.com.

Hapjen e faqeve të reja nga komunat MAPL e ka konsideruar shpërfillje të Udhëzimit Administrativ 2008/09, sipas së cilës çdo faqe zyrtare e Institucioneve të Kosovës duhet të ketë së paku tri elemente bazë: Kushtetutën e Kosovës, emërtimin zyrtar të Kosovës, Stemën e Kosovës, përfshirë Flamurin e Kosovës si dhe himnin e Kosovës. Faqja e hapur nga Komuna e Graçanicës nuk i përmban këto elemente⁴.

³<http://www.osce.org/kosovo/88762>

⁴ Lumnie Demi-Udhëheqëse e Zyrës për Informimë në MAPL

Tab. nr.5: Vlerësim i përmbajtjes së uebfaqes së Komunës së Graçanicës
<http://www.opstina-gracanica.com/>

Dokumenti	2010				2011				2012
	I	II	II I	IV	I	II	III	IV	I
Raporti i Punës së Kryetarit	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raporti financiar (buxhetor) i Komunës	x	x	x	√	x	x	√	√	√
Raportet e Drejtorisë së Administratës	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Arsimit	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mir.Sociale	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Inspektionit	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Financa, Ekonomi dhe Zhvillim	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Urbanizmi, Kadastru dhe Mjedesi	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Shërbimet Publike	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet dhe njoftimet e Zyrës së Prokurimit	Nuk ka asnjë publikim të kësaj natyre dhe madje nuk është e parapare as hapësira për vendosjen e këtyre raporteve.								
Raportet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm	√								
Procesverbalet e Kuvendit Komunal	√			√				√	
Rregulloret Komunale	Tri rregullore komunale janë të publikuara: Rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjoba dhe Rregullorja e tatimit në pronë si dhe Rregullorja për shërbimet në fushën e Katastrit dhe Gjeodezisë.								
Vendimet e Kuvendit Komunal	√			√				√	
Rregullorja e Punës së Kuvendit Komunal	x								
Procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Financa	x	x	x	x	x	x	x	x	x

Planet dhe Strategjitë e Komunës	Janë të publikuara: Plani i Punës i KK për 2012 si dhe mund te gjenden te listuara te gjithë projektet e realizuara gjate 2010 - 2011 dhe planifikimet për 2012
----------------------------------	---

X = mungon raporti.

√= raporti është i publikuar ne ueb-faqe

A.8. Përmbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009

Gjatë fushatës zgjedhore 2009, kandidati për kryetar komune, tani Kryetari i Komunës z.Bojan Stojanoviq, elektoratit të tij iu prezantua me një program qeverisës për periudhën katërvjeçare 2010-2013, në të cilin përshkruheshin hapat konkret të kryetarit të komunës në rast të zgjedhjes së tij për kryetar. Bazuar në këtë program qeverisës dhe pas monitorimit të gjitha premtimeve të dala nga fushata zgjedhore, Instituti GAP dhe BIRN, në 2010 i kanë shkruar letër të hapur Kryetarit të Komunës të cilit ia përkujtuan edhe një herë premtimet e dhëna, duke kërkuar njëkohësisht realizueshmërinë e tyre. Pas adresimit të letrës nga GAP-i Kryetari i Komunës z. Bojan Stojanoviq është përgjigjur me një letër dërguar përmes postes ku shpreh falënderimin dhe zotimin se premtimet e dhëna do të përmbushen në tërësi nga ana e tij dhe

vartëseve të tij. Komuna e Graçanicës ka qenë komuna e vetme në Kosovë e cila është përgjigjur në letrën e GAP dhe BIRN, duke premtuar se në mandatin katër vjeçar do të mundohen të përmbushin premtimet e dhëna.

Tabela më poshtë matë progresin e arritur në realizueshmërinë e premtimeve të dhëna në 2009. Në këtë tabelë janë përfshirë 11 premtime të dhëna. Në bazë të hulumtimit të GAP del se pas dy viteve të qeverisjes në komunën e Graçanicës, apo gjysmën e mandatit qeverisës, 4 premtime për katër fusha me rendësi për qytetin janë përmbushur, 5 të tjera nuk ka pasur nisma konkrete për realizueshmërinë e tyre, ndërsa 3 tjera ka pasur nisma dhe rezultate evidente, por akoma nuk mund të vlerësohen të përmbyllura.

Tab. nr.6: Premtimet 2009 nga Bojan Stojanoviq dhe realizueshmëria e tyre në 2010-2011

Premtimet e dhëna	Realizueshmëria
Investime në rrugë dhe parkingje, shkolla dhe çerdhe	Përgjithësisht është investuar në këto fusha. Janë shtruar dhe zgjeruar rruga nga ambulanca e qytetit deri në fshatin Dobratin. Është rregulluar rruga kryesore e qytetit e ndarë në katër faza. Është rregulluar shtrati i lumit përgjatë vendbanimit Prepoc. Po ashtu është ndërtuar shtrati i lumit në fshatin Dobertin dhe Zhegova. Shtrati i lumit është rregulluar edhe në fshatin Llapnasell. Parqet janë rregulluar në qendër përgjatë lumit që kalon qytetin si dhe është bërë ristrukturimi dhe rregullimi i parkut në fshatin Dobrotin.

	<p>Është rregulluar rruga për në fshatin Uglar. Rregullimi rrugës për në fshatin sushicë se bashku me murin mbrojtës. Janë ndërtuar tri shkolla fillore dhe pothuajse në të gjitha fshatrat e Graçanices është ndërtuar nga një çerdhe.</p>
Zhvillim ekonomik	<p>Nuk ka pasur ndonjë projektapo plan komunal i cili është bërë me qëllim të zhvillimit ekonomik. Zyrtarët komunal thirren në atë se rregullimi i infrastrukturës, rrjetit të shkollave dhe institucioneve tjera ndikon dhe e lehtëson zhvillimin ekonomik të kësaj zone.</p>
Përpilimin e planit të fizibilitetit me qëllim të punësimit të rinjve	<p>Nuk ka pasur ndonjë plan të tillë.</p>
Formimin e Këshillit Ekonomik i cili do të bashkëpunoj me firmat e Kosovës dhe më gjerë për të gjetur mundësinë më të mirë për investime ekonomike dhe gjenerimin e vendeve të punës.	<p>Nuk është formuar Këshilli Ekonomik.</p>
Zvogëlimin e numrit të vjedhjeve	<p>Komuna nuk ka të dhëna në lidhje me numrin e vjedhjeve që shënohen në territorin e saj. Komuna e Graçanicës deri në muajin maj të 2012 nuk ka formuar Këshillin Komunal për Siguri. Në javën e parë të muajit është mbajtur mbledhja inauguruese e këtij Këshilli. Pjesëmarrës në Këshill janë edhe zyrtarët e policisë të cilët për çdo muaj do të kenë obligim t'i prezantojnë komunës të dhënat në lidhje me sigurinë dhe incidentet e ndodhura.</p>

<p>Ndërtimin e një spitali me vlerë prej 1 milion euro</p>	<p>Ndërtimi këtij spitali ka nisur në gjysmën e dytë të vitit 2011. Punët akoma nuk janë përmbyllur. Komuna fillimisht ka ndarë 350 mijë euro për këtë qellim, ndërsa Qeveria e Kosovës për këtë vit ka ndarë edhe 200 mijë euro. Ndërtimi i këtij spitali bëhet në afërsi të liqenit akumulues të ujit në Badovc.</p>
<p>Ndërtimi i depos bujqësore</p>	<p>Nuk është bërë.</p>
<p>Renovimin dhe ndërtimin e qendrave të reja sportive</p>	<p>Përgjithësisht është punuar në këtë sferë dhe rezultatet e shënuara janë inkurajuese. Komuna ka arritur që edhe në disa fshatra të ndërtoj qendra të ashtuquajtura rekreative-sportive. Një e tillë gjendet në fshatin Sushicë. Ndërtimet në këtë fushë janë bërë kryesisht fal donacioneve nga Qeveria e Kosovës apo edhe donatorët ndërkombëtar.</p>
<p>Ndërtimin e shtëpisë së gjuetarëve në Llapnasellë</p>	<p>Nuk është bërë.</p>
<p>Zgjedhja e problemit të rrymës duke ngritur vetëdijesimin/inkurajimin e popullatës për pagesën e rrymës</p>	<p>Sipas të dhënave zyrtare të KEK-ut Komuna e Graçanicës është 98% pagues e rrymës, gjë e cila ndikon edhe në furnizimin stabil me energji elektrike. KEK-u pati ngrirë borxhet e kaluara banorëve të Graçanicës nga viti 1999 -2010, duke u kërkuar borxhet vetëm nga fillimi i 2010, kjo merret edhe si indikacion i cili ka shënuar rritjen e pagesës nga ana e banorëve të Graçanicës kundruall KEK-ut.</p>

B. Letërnjoftimi i Komunës së Ranillugut 2012

B.1. Hyrje

Komuna e Ranillugut banohet kryesisht me serbë. Kjo Komunë është formuar nga territori i Komunës së Kamenicës. Ranillugu ka marrë 15% të territorit të Komunës së Kamenicës. Ranillugu e ka një shtrirje gjeografike në pjesën lindore të Kosovës me një sipërfaqe prej 74.28 km katrorë, në të cilën jetojnë përafërsisht 5.200 banorë. Komuna e Ranillugut kufizohet me Komunën e Kamenicës në veri, me Komunën e Novobërdës në perëndim dhe me Gjilanin në juglindje. Ranillugu përbëhet nga 13 zona kadastrale.

Kryetar i Komunës së Ranillugut është Gradimir Mikic nga partia “Iniciativa Qytetare për Komunën e Ranillugut”, e cila në zgjedhjet e nëntorit të 2009 ka marrë 11 ulëse në Kuvendin e Komunës, pasuar nga “Partia e Serbeve të Kosovës dhe Metohisë” e cila ka fituar 4 vende në Kuvend. Kuvendi i Komunës së Ranillugut numëron 15 anëtarë. Numri i drejtorive komunale është 6. Gradimir Mikic, para se të zgjidhej kryetar i Ranillugut, për dy vite (2007-2009) ka qenë nënkryetar i Komunës së Ranillugut.

Komuna e Ranillugut ka marrë këtë emërtim për shkak të fshatit më të madh të banuar me serbë, por administrata komunale e kësaj komune të re nuk gjendet në Ranillug por është e shpërndarë në Domaroc dhe Ropotovë. Komuna e Ranillugut nuk ka mundur të vendoset në fshatin Ranillug për shkak të kundërshtimit të serbëve dhe strukturave paralele të cilat dirigojnë dhe financohen nga Qeveria e Serbisë.

B.2. Performanca buxhetore e Komunës së Ranillugut

Pjesa më e madhe e territorit të Komunës së Ranillugut përbëhet prej tokës bujqësore. Ekzistojnë shumë pak biznese në këtë komunë, rreth 110 biznese, kryesisht shitore apo minimarkete. Për këtë arsye vjelja e taksave prej bizneseve është shumë e vogël. Në vitin 2011 të hyrat nga taksat për bizneset ishin 1.390 euro.

Nga të hyrat vetanake duket se të hyrat nga dënimet që i ka shqiptuar inspekcioni janë mjaft të larta në krahasim me të hyrat tjera. Në 2011 të hyrat nga dënimet e inspekcionit ishin 4.275 euro, çfarë tregon për një angazhim të inspektoratit komunal. Të hyrat nga gjambat e inspekcionit janë shumë më të mëdha se të hyrat në komunat tjera (natyrisht duke marrë parasysh madhësinë e komunës dhe aktivitetin ekonomik që ushtrohet).

Edhe në tre mujorin e parë të 2012 ka vazhduar ky trend i gjobave të inspektoratit ku për periudhën janar-mars 2012 janë shqiptuar dënime në vlerë prej 1.110 euro.

Të hyrat vetanake të Ranillugut janë mjaft inkurajuese, duke marrë parasysh aktivitetin e varfër ekonomik që ushtrohet në këtë Komunë. Të hyrat vetanake në 2011 ishin 78 mijë euro, dukshëm më shumë se në 2010 (44 mijë euro). Të hyrat vetanake për tre mujorin e parë të 2012 janë më të mëdha për 3.7% në krahasim të njëjtën periudhë të një viti më parë. Çfarë tregon se të hyrat vetanake të Ranillugut për 2012 pritet të jenë më të mëdha se ato të 2011. Sa i përket të hyrave vetanake, Ranillugu ka treguar dukshëm performancë më të mirë se sa komunat tjera të reja me madhësi dhe specifika të njëjta me Ranillugun, siç janë Parteshi, Klllokoti, Mamusha, Juniku.

Një e hyrë buxhetore këtu që nuk vërehet nga komunat tjera është taksa për kontrollin e ushtruar në respektimin e planit rregullues, ku në 2011 nga kjo taksë Komuna janë evidentuar të hyra prej 3.406 eurove. Në tre mujorin e parë të 2012 të hyrat nga kjo taksë janë 727 euro.

Mirëpo, përkundër performancës së mirë të vjeljes së të hyrave vetanake, Komuna e Ranillugut nuk e ka disiplinën e njëjtë sa i përket shpenzimit të parasë publike. Në 2010 vetëm për dreka zyrtare janë shpenzuar 6.660,5 euro. Kjo shumë është e baras vlefshme me shumën e të hyrave vetanake të grumbulluara nga këto aktivitete komunale:

Tab. nr.7: Disa nga shpenzimet në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve

Përshkrimi	Shuma 2010
Taksa nga Regjistrimi i Automjeteve	90.00
Taksa nga Regjistrimi i Bizneseve	350.00
Taksa nga lejet e ndërtimit	863.40
Taksa për destinimin e tokës	80.00
Nga Certifikatat e lindjes	763.00
Nga kurorëzimi	11.00
Taksë për verifikimin e dokumenteve	3.246.00
Dënime nga inspekcioni	160.00
Qiraja nga objektet publike	165.00
Nga verifikimet urbanistike	961.00
GJITHSEJ:	6.689

Kurse, nga Raporti Financiar i Komunës së Ranillugut për 2011 del se për dreka zyrtare janë shpenzuar 1.935 euro, çfarë do të thotë se shpenzimet e Komunës për 2010 për këtë kategori kanë qenë enorme.

Kategori tjetër ku vërehen shpenzime të mëdha janë edhe shpenzimet për mëditje për udhëtime jashtë vendit. Në 2010 shpenzimet për udhëtimet jashtë vendit kanë kushtuar 1.455 euro, kurse shpenzimet për mëditjet e këtyre udhëtimeve kanë kushtuar 8.811 euro. Çka do të thotë se mëditjet kanë kushtuar tetë fish më shuam se sa vetë udhëtimet. I njëjti trend ka vazhduar edhe më 2011, ku shpenzimet për udhëtime jashtë vendit kapin vlerën prej 1.372 eurosh, kurse mëditjet për të njëjtë udhëtime kapin vlerën prej 8.448 eurosh. Pjesën më të madhe të këtyre mëditjeve e ka marr Zyra e Kryetarit, apo 5.411 euro në 2010 dhe 6.618 euro për 2011.

Shpenzimet për karburante të veturave janë të mëdha, kur të kihet parasysh numër i vogël i automjeteve zyrtare dhe madhësia e territorit të Komunës prej 77.6 km/2. Në 2011 shpenzimet për derivate kapin shumën prej 13.132 eurosh. Edhe për mirëmbajtjen e automjeteve janë shpenzuar shuma të mëdha, ku vetëm në 2011 janë shpenzuar 7.019 euro.

Edhe shpenzimet e telefonisë mobile dhe asaj fikse janë të mëdha, ku së bashku kapin vlerën vjetore prej 9.456 euro (6.330 për telefoni mobile dhe 3.126 për atë fikse).

Një e dhënë e cila nuk është evidentuar në raportet financiare të Komunës për 2010 dhe 2011 është edhe shpenzimi për drunj dekorativ për festat e fundvitit. Në dhjetor të 2011, Komuna e Ranillugut i ka dhënë tender ndërmarrjes nga Gjilani NPN "S6G CONSTRUCTION" për furnizim të Komunës me drunj dekorativ për festat e fundvitit. Këta drunj dekorativ i kanë kushtuar Komunës 9.840 euro! Nuk ka të dhëna për sasinë e drunj dekorativ që ka blerë Komuna si dhe ku janë vendosur ata. Po ashtu në dhjetor 2011 me një tender tjetër janë shpenzuar 4.966 për furnizim për material dekorues për vitin e ri.

Buxheti total i Ranillugut për 2011 ishte 1.505.264,73 euro, prej tyre 785.416 euro janë të dedikuara për paga, 227.021 euro për mallra dhe shërbime, 25.000 për shpenzime komunale, 15.866 për subvencione dhe 451.931 për investime kapitale.

Tab. nr.8: Disa nga shpenzimet në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve - 2011

Pershkrimi i shpenzimit të buxhetit sipas sektorëve 2011	Shuma (euro)
Zyra e Kryetarit - (Investimet kapitale)	529.710.82
Administrata dhe personeli	184.103.66
Kuvendi i Komunës	53.620.35
Drejtorja për Buxhet dhe Financa	42.550.89
Administrata për tatimin në pronë	1.989.35
Drejtorja e Shërbimeve Publike	21.378.15
Zyra për Komunitete	2.477.30
Drejtorja për Bujqësi	12.312.84

Drejtoria e Urbanizimit dhe Katastrit	44.582.77
Administrata në shëndetësi	27.174.75
Shëndetësia Primare	152.330.94
Shërbimet Sociale	11.553.30
Arsimi para shkollor	47.729.29
Arsimi Fillor & Drejtoria	204.605.41
Arsimi i mesëm	69.501.04

Komuna e Ranillugut në vitin 2011 ka pasur suficit në vlerë prej 59.190,10 euro, para këto që i janë kthyer buxhetit qendror. Ky suficit ka rezultuar në linjën për paga, në linjën për mallra dhe shërbime dhe një shumë afro 3.000 euro suficit ka dal edhe në linjën e investimeve kapitale.

Tek kategoria e mallrave dhe shërbimeve, vërehet rritje e shpenzimeve në 2011 në krahasim me 2010. Kësisoj, në 2011 në linjën e ashtuquajtur “shpenzime të tjera kontraktuese” janë shpenzuar mjete në vlerë prej 69.843 euro, përderisa një vit me herët (2010) në të njëjtën linje janë shpenzuar 10.869 euro. Në linjën “blerja e drunjve” për djegie në 2011 janë shpenzuar 9.994 euro, një vit me herët në të njëjtën linje janë shpenzuar 1.620 euro. Për mirëmbajtjen e automjeteve në 2011 janë shpenzuar 7.019 euro, ndërsa në 2010 në të njëjtën linje janë shpenzuar 1.551 euro. Po ashtu të shpenzimi i energjisë elektrike vërehet një rritje enorme e pagesave, kësisoj gjatë 2011 janë paguar faturat nga komuna për KEK-un në vlerë prej 20.695 euro, përderisa një vit me herët shpenzimet për rrymë kanë qenë 13.389 euro.

Auditori i Përgjithshëm në raportin e tij për performancën e rregullsisë së Komunës së Ranillugut për vitin 2010 ka gjetur këto parregullsi:

- a. Te kontrata “Furnizimi me minibus dhe kombi për nevojat e komunës” në vlerë prej 98,850 € Auditori ka vërejtur se kontrata i ishte dhënë operatorit të papërgjegjshëm. I mungonte dëshmia për kryerjen e obligimeve për rrymë ndaj KEK - ut dhe autorizimi nga prodhuesi.
- b. Komuna nuk ka përgatitur planin final të prokurimit.
- c. Numri i aprovuar i punonjësve ishte 180 ndërsa numri i tyre në fund të vitit ishte 209, i cili tejkalon numrin e aprovuar për 29 punonjës.
- d. Nuk ekziston regjistër i plotë i pasurisë së Komunës

Komuna e Ranillugut nuk ka arritur akoma të themeloj dhe funksionalizoj Njësinë e Auditimit të Brendshëm. Në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 thuhet në mënyrë eksplicite se Komunitat kanë obligim ligjor për të bërë auditim të brendshëm, së paku një herë në vit.

B.3. Administrata e Komunës së Ranillugut

Komuna e Ranillugut ka të punësuar 53 persona në administratën komunale. Ky numër i të punësuarve është më i madh se numri i të punësuarve të lejuar. Sipas MAPL⁵ Komuna e Ranillugut ka të drejtën të punësoj 50 persona në administratë komunale, kurse kjo Komunë ka të punësuar në administratë 53 persona. Numri i gjithëmbarsuem i të punësuarve prej 189 personave (administratë, arsim dhe shëndetësi) është më i madh se numri i stafit të lejuar nga Ministria e Financave, me Buxhetin e Kosovës. Në vitin 2010 kjo komunë kishte të punësuar 209 veta, apo 29 veta më shumë se numri i lejuar për punësim. Po ashtu GAP-i ka evidentuar që një pjesë e stafit të Komunës së Ranillugut nuk janë banorë të kësaj komune.

Tab. nr.9: Të punësuarit në arsim, shëndetësi dhe administratë lokale në Ranillug

Sektorët	Numri i të punësuarve
Zyra e Kryetarit	7
Drejtorja e Administratës	18
Drejtorja e Financave	9
Drejtorja e Bujqësisë	4
Drejtorja e Gjeodezisë	6
Spektori i Arsimit	100
Spektori i Shëndetësisë	36
Drejtorja e Sherbimeve Publike	7
Zyra e Komuniteteve	2
Gjithsejt	189

Përveç numrit të madh të të punësuarve, shkelje tjetër në këtë komunë është edhe mënyra e pranimit të stafit dhe dosjet e stafit. Auditori i Përgjithshëm në 18 dosje që ka marr si mostër për të testuar më 2010, asnjëra prej tyre nuk ka qenë e rregullt. Nuk kanë ekzistuar dëshmi për kualifikimin e stafit dhe ka munguar përshtkrimi i detyrave të punës. Sipas Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) mungesa e diplomave rrit rrezikun e punësimeve pa kriter, kurse mungesa e përshtkrimit të vendeve të punës i pamundëson stafit të pranuar që të kryej detyrat administrative.

Në bazë të kualifikimit shkollor, sipas një raporti të Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil në MAP), del se asnjë nga stafi i Komunës nuk është me fakultet, kurse 23 veta janë me shkollim të lartë. Edhe numri i të punësuarave femra është i vogël, apo

⁵ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Raport i Monitorimit të Komunave të Kosovës 2011. Publikuar më 23 janar 2012.

vetëm 13 femra dhe 40 meshkuj. Por në ekzekutivin e Komunës femrat janë të përfaqësuara mirë, ku nga 6 drejtori funksionale, 2 drejtori udhëhiqen nga femrat.

Nënkryetari i Komunës së Ranillugut, Lulzim Canaj, është nga fshati Koretin i Komunës së Kamenicës. Në mandatin e kaluar Lulzim Canaj ka qenë Drejtor i Shërbimeve Publike në Kamenicë nga radhët e AKR. Nënkryetari i Komunës do të duhej të ishte nga radhët e komunitetit shqiptar që banojnë në kuadër të Komunës së Ranillugut dhe jo nga një komunë tjetër. Po ashtu Drejtori i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit është Xhavit Krasniqi nga fshati Dajkoc i Komunës së Kamenicës. I njëjti ka qenë Drejtori i Drejtorisë së Ekonomisë në mandatin e kaluar në Komunën e Kamenicës nga radhët e PDK.

B.4. Investimet kapitale

Investimet kapitale nga Komuna e Ranillugut gjatë dy viteve të kaluara (2010-2011) nuk kapin shifrën e 1 milionë eurove. Gjatë vitit 2010 kryesisht investimet kapitale janë shtrirë në përmirësimin, zgjerimin dhe asfaltimin e rrugëve. Përderisa gjatë 2011 mbi 90% e investimeve kapitale janë fokusuar në rregullimin dhe shtrirjen e rrjetit të kanalizimit dhe rrjetit të ujësjellësit. Në tabelën e mëposhtme do të hasen projektet kryesore të realizuara gjatë dy viteve të kaluara në territorin e Komunës së Ranillugut.

Tab. nr.10: Projektet kapitale të realizuara në Komunën e Ranillugut 2010-2011

Projektet e realizuara	Shuma (Euro)
Asfaltimi i rrugëve ne Korminjan dhe fusha sportive ne Domoroc	13.273
Ndërtimi i ujësjellësit ne Rajanoc	83.525
Rekonstruimi i përroit ne Ranillug	9.918
Rregullimi i toaleteve publike në Domoro	4.990
Lidhja e pusetave me rezervarin ne Ranillug	14.946
Rregullimi i parkut ne Ranillug	21.232
Ndërtimi dhe rregullimi i rrugëve në fshatin Ropotovë si dhe ndërtimi i kanalizimit në fshatin Domarvcë	138.840
Ndërtimi i objektit banesor në Ranillug	478.350
Ndërtimi i urës në fshatin Ropotovë e Madhe dhe ndërtimi i urës në fshatin Korminjan i Epërm	112.000
Renovimi i tri shtëpive te kulturës	149.799

Ndërtimi i parkingut për shkollën, ambulanten dhe shtëpinë e kulturës në Ropotovë të madhe	7.479
--	-------

B.5. Aktivitetet e prokurimit publik 2010-2011

Për dy vite (2010-2011) Komuna e Ranillugut ka lidhur nëpërmjet procedurave të prokurimit 66 kontrata në vlerë të përgjithshme mbi 1.7 milionë euro. Janë disa raste kur procedurat e prokurimit janë kryer nga ana e Komunës së Ranillugut, ndërsa mjetet kanë qenë të dedikuara për projekte të caktuara nga ana e institucioneve qendrore të Kosovës, kjo veçmas ka qenë karakteristik e vitit 2010.

Tab. nr. 11: Kontratat e Prokurimit në Komunën Ranillugut
2010-2011

Viti	Nr. i kontratave	Vlera e kontratave (Euro)
2010	27	1.410.719.41
2011	39	345.166.26
Total	66	1.755.885.67

Burimi: KRPP Raporti për 2010 dhe 2011

Komuna e Ranillugut ende nuk ka arrit të stabilizohet me staf dhe procedura Njësinë e Prokurimit Publik. Fillimisht menaxher i kësaj njësie të rëndësishme ka qenë Enlirat Kallaba. Pas tij me këtë zyrë ka menaxhuar Hasan Keqmezi. Hasan Keqmezi ka qenë menaxher i prokurimit në Komunën e Kamenicës për shumë vite dhe është larguar nga ky post me vendim të Kryetarit të Komunës. Z.Keqmezi është ankuar në KPM, por në ndërkohë ai ka punuar në Zyrën e Prokurimit në Ranillug. Pasi që KPM ka konstatuar se z.Keqmezi është larguar padrejtësisht nga puna si menaxher i prokurimit në Kamenicë, ai është kthyer të punoj në Kamenicë, por jo në vendin e tij të mëparshëm, por si Zyrtar Juridik në Drejtorinë e Kulturës. Në këtë periudhë ushtrues detyre i menaxherit të prokurimit është Gradimir Djordjevic. Në fund të prillit 2012 Komuna e Ranillugut ka shpallur konkurs për menaxher të prokurimit. Edhe pse konkursi është ende i hapur, me një siguri të lartë të gjithë shprehen se në atë post do të kthehet Hasan Keqmezi, i cili nuk është i kënaqur me sistemimin e tij në kuadër të Drejtorisë së Kulturës në Kamenicë (edhe pse rasti i tij është duke u shqyrtuar nga Gjykata e Kamenicës për rikthim më vendin e tij të punës si menaxher i Njësisë së Prokurimit në Kamenicë). Hasan Keqmezi është kritikuar për punën e tij si menaxher i prokurimit në raportet e Auditorit Gjeneral. Hasan Keqmezi ka punuar edhe si menaxher i prokurimit edhe në Komunën e Kllokotit. Të gjithë përgjegjësit e prokurimit në Komunën e Ranillugut kanë qenë dhe janë nga Komuna e Kamenicës (Enlirat Kallaba - Kamenicë, Hasan Keqmezi - Koretin, Gradimir Djordjevic - Berivojcë).

B.6. Arsimi dhe Shëndetësia

Sistemi shëndetësor dhe arsimor në Komunën e Ranillugut funksionon afërsisht ngjashëm si të rasti i Komunës së Graçanicës. Përgjegjësit e këtyre qendrave nuk i japin përgjegjësi Komunës, por strukturave paralele të cilat menaxhohen dhe financohen direkt nga Qeveria e Serbisë. Pjesa dërmuese e stafit në këto qendra pranojnë rrogën edhe nga Komuna e Ranillugut dhe njëherazi rroge marrin edhe nga Qeveria e Serbisë. Në asnjë raport të nivelit qendror (MASHT dhe MSH) nuk mund të hasen shifra për numrin e të punësuarve në sistemin arsimor dhe shëndetësor në Ranillug me arsyetimin se këto qendra nuk raportojnë tek institucionet e Kosovës.

Edhe përkundër kësaj, Komuna e Ranillugut në vazhdimësi ka investuar në këto qendra, madje ka paraparë buxhet edhe në linjën e mallrave dhe shërbimeve për këto qendra. Rrjedhimisht nga kjo, Komuna e Ranillugut shpenzon para për rrymën, ujin, mbeturinat dhe shpenzimet e tjera operative për qendrat e mjekësisë dhe objektet arsimore, ndonëse nuk janë nën autoritetin e tyre.

Sistemi shëndetësor përfshin Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) dhe 5 punkte apo ambulanca shëndetësore, ku punojnë gjithsej 33 persona, prej tyre vetëm 2 mjek specialist.⁶

Ndërsa sistemi arsimor përfshin 2 shkolla fillore me 563 nxënës dhe 87 mësues, dy 2 shkolla të mesme me 355 nxënës dhe 48 mësues dhe 35 teknik, dhe një një çerdhe me afro 100 fëmijë dhe 11 mësues.⁷

B.7. Transparenca

Autoritetet e Komunës së Ranillugut nuk e kanë parë me prioritet asnjëherë çështjen e transparencës komunale. Në organogramin e këtij institucioni askund nuk haset e themeluar zyra për informim, apo ndonjë person ose departament që është përgjegjës për ushtrimin e këtij funksioni. Përveç kësaj, informatat që dalin në faqen zyrtare të komunës përgjithësisht kanë të bëjnë me aktivitetet e zyrës së kryetarit dhe agjendën ditore të tij dhe askund nuk hasen dokumentet me rendësi për qytetarët, opinionin dhe vetë komunën. Asnjë rregullore, vendim, plan rregullues nuk është publikuar në faqen zyrtare të komunës. As për vitet 2010 – 2011 nuk gjenden raportet e buxhetit, qoftë ai i miratuar, qoftë raportet mbi shpenzimet komunale.

⁶ OSCE. Municipal Profiles – Ranillug. Nëntor 2011. Burimi: <http://www.osce.org/kosovo/88760>

⁷ Po aty, <http://www.osce.org/kosovo/88760>

Tabela nr.12: Vlerësim i përmbajtjes së uebfaqes së Komunës së Ranillugut
 kk.rks-gov.net/ranillug/

Dokumenti	2010				2011				2012
	I	II	II I	IV	I	II	III	IV	I
Raporti i Punës së Kryetarit	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raporti financiar (buxhetor) i Komunës	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Administratës	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Arsimit	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Shëndetësisë	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Inspektionit	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Financa, Ekonomi dhe Zhvillim	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Urbanizëm, Kadaster dhe Mjedis	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Shërbimet Publike	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet dhe njoftimet e Zyrës së Prokurimit	Nuk ka asnjë publikim të kësaj natyre dhe madje nuk është e parapare as hapësira për vendosjen e këtyre raporteve.								
Raportet e Njësisë së Auditimit të Brendshëm	x								
Procesverbalet e Kuvendit Komunal	x			x				x	
Rregulloret Komunale	Asnjë rregullore apo vendim komunal nuk është i postuar në faqen zyrtare.								
Vendimet e Kuvendit Komunal	x			x				x	
Rregullorja e Punës së Kuvendit Komunal	x								
Procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Financa	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Planet dhe Strategjitë e Komunës	x								

X = mungon raporti.

√= raporti është i publikuar në ueb-faqe

B.8. Përmbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009

Gjatë fushatës zgjedhore 2009, kandidati për kryetar komune, Gradimir Mikiq, në debatin parazgjedhor në “Jeta në Kosovë” dhe në paraqitjet e tij tjera publike, elektoratit iu prezantua me një mori premtimesh për ti realizuar në rast se zgjidhet kryetar komune. Pas monitorimit të gjitha premtimeve të dala nga fushata zgjedhore, Instituti GAP dhe BIRN, në 2010 i kanë shkruar letër të hapur Kryetarit të Komunës të cilit ia përkujtuan

edhe një herë premtimet e dhëna, duke kërkuar njëkohësisht realizueshmërinë e tyre.

Tabela më poshtë mat progresin e arritur në realizueshmërinë e premtimeve të dhëna në 2009. Në këtë tabelë janë përfshirë 5 premtime të dhëna. Në bazë të hulumtimit të GAP del se pas dy viteve të qeverisjes në komunën e Graçanicës, apo gjysmën e mandatit qeverisës, 2 premtime janë përmbushur, 3 te tjera nuk ka pasur nisma konkrete për realizueshmërinë e tyre.

Tab. nr.13: Premtimet 2009 nga Gradimir Mikiq dhe realizueshmëria e tyre në 2010-2011

Premtimet	Realizueshmëria
Ndërtimin e rrugës Ranillug, Glogovc, Kremjan i Epërme dhe i Poshtem deri në fund të mandatit (do të mbeten vetëm 1.100 km të pandërtuara)	Nuk është realizuar nga Komuna e Ranillugut.
Ndërtimin e kanalizimit në fshatin Domoroc;	Premtim i realizuar. Kanalizimi në fshatin Domoroc është ndërtuar më 2011 dhe ka kushtuar 46.785 euro.
Përkujdesje për ambientin: pastrimin e ujërave të zeza në lumin Moravë si dhe pastrimin e fshatrave nga mbeturinat	Në përgjithësi ambienti në komunën e Ranillugut është i pastër. Komuna ka investuar në rrjetin e kanalizimit të ujërave të zeza në Domoroc. Komuna po ashtu ka rregulluar përroin në Ranillug në një projekt që ka kushtuar 9.918 euro, si dhe një tender tjetër në vlerë prej 24.980 eurosh.
Themelimin e kompanisë komunale për	Premtim i pa realizuar.

<p>menaxhimin e mbeturinave, e cila do të ketë kamionin për mbledhjen e mbeturinave, furnizim me konteniera, formimin e deponisë së komunës, me ç’rast do të ulet edhe pagesa për kontenier</p>	
<p>Ngritjen e vetëdijes tek qytetarët për mirëmbajtjen e ambientit</p>	<p>Nuk sëhtë bërë mjaft në ngritjen e vetëdijes qytetare për ruajtjen e ambientit e sidomos në krijimin e mekanizmave që ruajnë ambientin.Në “Ditën e Tokës” më 22 prill 2012 komuna ka ndërmarrë një aksion për pastrimin e ambientit në Ropotovë të Madhe, ku kanë marr pjesë të gjithë punëtorët e administratës, arsimit, ku ka asistuar edhe KFOR.</p>

C. Letërnjoftimi i Komunës së Kllokotit 2012

C.1. Hyrje

Komuna e Kllokotit, me popullsi me shumicë serbe, shtrihet në pjesën juglindore të Kosovës. Përbëhet nga katër zona kadastrale me një sipërfaqe 23.39 km katrorë dhe me popullsi prej afërsisht 4.800 banorësh: 72% serb dhe 28% shqiptar. Formimi i Komunës së Kllokotit është bërë në territorin e Komunës së Vitisë. Transferimi i kompetencave nga kjo e fundit në Komunë të Kllokotit është bërë në bazë të një marrëveshje mirëkuptimi mes kësaj komune dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Kryetar i Komunës së Kllokotit është Sasha Mirkoviq i cili përfaqëson Partinë Liberale Serbe (SLS) e cila ka 10 ulëse në Kuvendin Komunal, pasuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës e cila ka 5 ulëse. Këto dy parti bashkë-qeverisin në Kllokot. Në Kuvendin Komunal të Kllokotit nuk ekziston asnjë parti opozitare.

C.2. Performanca buxhetore e Komunës së Kllokotit

Komuna e Kllokotit gjatë vitit 2011, ka pasur buxhet në vlerë prej 885 mijë euro, pjesa kryesor është nga granditë qeveritar, kurse 8 mijë e 390 euro janë të hyra vetanake. Prej buxhetit total, 129 mijë euro kanë qenë të dedikuara për investime kapitale. Komuna e Kllokotit mund të jetë e vetmja në vend e cila ka buxhet dukshëm më të vogël në krahasim me një vit më herët, përkatësisht gjatë vitit 2010 shuma totale e buxhetit ka qenë 1.123.833 euro.

Komuna e Kllokotit gjatë dy viteve të kaluara 2010 -2011 për nga shkalla e të hyrave vetanake nuk e ka kaluar shifrën e 9.000 eurove, ndërsa vetëm gjatë vitit 2010 shpenzime të udhëtimit kjo komuna ka pasur në vlerë prej 11.782,72 euro. Po ashtu shpenzimet për dreka dhe darka gjatë vitit 2010 janë të përafërta me shkallën totale të të hyrave komunale 2010. 6.028 euro janë shpenzuar për dreka zyrtare. Për mirëmbajtjen e veturave dhe pajisjeve tjera Komuna e Kllokotit gjatë një viti (2010) ka shpenzuar 14.754 euro, për derivate dhe lëndë djegëse 18.270 euro, për telefona mobil 2.335 euro, etj.

Shkalla totale e të hyrave vjetore nuk i përmbush as përafërsisht shpenzimet që kjo komunë bënë për objektin ku qëndron me qira. Komuna e Kllokotit paguan 3.100 euro në muaj qira për objektin i cili është marr me qira për t'u shndërruar në komunë dhe nuk ka pasur ndonjë projekt, nismë apo iniciativë që komuna të ndërtojë një objekt

komunal. Kjo është vështirësuar dhe pamundësuar edhe nga fakti që autoritetet e Kllkotit nuk e kanë asnjë metër katror pronë nën menaxhimin e tyre. E gjithë prona është private, apo shoqërore e cila menaxhohet nga AKP.

Komuna e Kllkotit ka vështirësi edhe në pagimin e borxheve komunale. Fshati Mogill të cilit nga komuna i është rregulluar ndriçimi publik, pas tre muajve ndriçimi i është ndërpre nga KEK-u dhe tash e një vit ndriçimi nuk është rikthyer ngase autoritetet arsyetohen që nuk kanë mjete për të paguar shpenzimet e energjisë elektrike të cilat i bënë sistemi i ndriçimit publik.

Sipas Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës (ZAP), Komuna e Kllkotit gjatë 2010 nuk ka mbajtur evidenca rreth realizimit të hyrave nga departamenti i financave dhe departamentet që realizojnë të hyra. Sipas (ZAP), Departamenti i financave nuk ka pranuar asnjë raport mujor, tremujor apo vjetor për të hyrat e realizuara gjatë vitit 2010 nga departamentet përkatëse të cilat realizojnë të hyra.

C.3. Administrata në komunën e Kllkotit

Administrata e Komunës së Kllkotit përbehet nga gjithsej 57 të punësuarve, pa përfshi këtu të punësuarit në sektorin e shëndetësisë dhe atij të arsimit. Me dy sektorët e fundit numri total i të punësuarve në Komunën e Kllkotit është 124. Numri më i madh i te punësuarve është në sektorin e arsimit.

Tab. nr.14: Numri i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratën komunale të Kllkotit

Sektorët	Numri i të punësuarve
Zyra e Kryetarit	7
Drejtorja e Administratës	23
Drejtorja e Financave	6
Drejtorja e Bujqësisë	1
Drejtorja e Gjeodezisë	3
Drejtorja e Kulturës	2
Spektori i Prokurimit	2
Spektori i Arsimit/para fillor/fillor dhe i mesëm	55
Spektori i Shëndetësisë	15
Drejtorja e Urbanizimit	3
Drejtorja e Sherbimeve Publike	6
Zyra e Komuniteteve	1
Gjithsej	124

Në pjesën më të madhe të orarit të punës Kryetari i Klllokotit Saša Mirkovič nuk qëndron në zyre dhe gjatë kësaj kohe nuk ushtron ndonjë aktivitet komunal. Ai zakonisht shihet në kafiteritë e qytetit. Sipas burimeve të GAP-it, kryetari i Klllokotit ka edhe me javë të tera që nuk shkon në zyrën e tij të punës në komunë.

Kjo ngjet edhe me stafin tjetër të Komunës. Nuk ka rregull, disiplinë, përgjegjësi dhe llogaridhënie për vendin e punës dhe as për orarin zyrtar të punës. Veturat zyrtare (7 të tilla) përdoren pa kriter dhe zakonisht shfrytëzohen për distanca të largëta, jashtë territorit të komunës.

Komuna e Klllokotit ju ka mundësuar të gjithë të punësuarve shkuarjen dy ditë në Shqipëri (Durrës), kjo ka ngjarë në fillim të muajit shtator të 2011. 35 persona kanë shkuar nga gjithsej 57 të punësuarve.

Menjëherë pas kësaj, kryetrari i Klllokotit ka kërkuar që stafi të dërgohet (në formën eskurzionit) edhe në Beograd. Kjo është realizuar, por kanë shkuar vetëm femrat e punësuarra në Komunë. Vizita ka zgjatur nga e premtdja deri të dielën në javën e parë të tetorit të vitit 2011.

Kryetari i Komunës ka shkarkuar zëvendësin e tij Zoran Bogdanovic. Ish-nënkryetari i parë i kësaj komune, z.Bogdanovic, ka thënë për media se kryetari e ka larguar nga puna atë vetëm pse djali i tij në zgjedhjet e fundit nacionale ka qenë në listë për deputet, në një parti tjetër serbe, Listën e Bashkuar Serbe, e jo në Partinë Liberale Serbe – SLS, e cila është në pushtet.

Kritika ndaj Kryetarit të Komunës ka adresuar edhe ish Drejtori i Bujqësisë i kësaj komune Hasan Rashiti i cili është shkarkuar nga kjo detyrë nga kryetari i Komunës. Rashiti ka thënë se largimi i tij lidhet me kundërshtimin që ai i ka bërë Kryetarit për pranimin pa konkurs të disa personave në Drejtorinë e Bujqësisë.

Sipas raportit të Auditorit të përgjithshëm (ZAP) i cili i referohet vitit 2010 për Komunën e Klllokotit ka gjetur se ka parregullsi si gjatë procesit të rekrutimit të punëtorëve. Sipas Auditorit, dosjet personale të punonjësve nuk janë të strukturuar dhe të azhurnuara si duhet. "Në të gjitha dosjet e testuara të rekrutimit kemi vërejtur se mungojnë raportet për rezultatet e vlerësimit të aplikantëve të cilët kanë konkurruar për këto pozita. Po ashtu, në dosjet personale mungojnë edhe vlerësimet e fundvitit të stafit", thuhet në raport. Më tej thuhet se komuna ka bërë punësim të personave të cilët nuk i kanë plotësuar kualifikimet e nevojshme të kërkuara me konkurs.⁸

⁸ Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2010 – Publikuar në korrik të 2011 për Komunën e Klllokotit

Po sipas Auditorit në shtatë raste kandidatët që janë përzgjedhur nuk i kanë plotësuar kriteret e kërkuara. Po ashtu, edhe paga në kontratë nuk përputhet me pagën në sistemin e pagave.

“Në një mostër kemi gjetur se nuk përputhet paga në kontratë me pagën në sistemin e pagave. Trajtimi i rekrutimeve dhe i dosjeve të personelit në komunë nuk i ka përmbushur kërkesat”.

C.4. Investimet kapitale

Investimet kapitale në Komunën e Klllokotit janë të pakta dhe kjo vije në radhë të parë për shkak të buxhetit të vogël komunal. Buxheti për investime kapitale për një vit në Komunën e Klllokotit nuk ka kaluar shifrën 450.000 euro. Këtë vit (2012) kjo shifër është për rreth 22.000 euro më e madhe.

Pjesa më e madhe e investimeve në zonat e Klllokotit ka ardhur nga Qeveria e Kosovës dhe po ashtu investime shumëdimensionale ka pasur edhe nga ana e donatorëve ndërkombëtar.

Tab. nr.15: investimet kapitale 2010-2011 nga Komuna e Klllokotit

Projektet kryesore të realizuara gjatë 2010 -2011	Vlera (euro)
Rregullimi i parkut në oborrin e shkollë "Marko Rajkovic" në fshati Verbovc	9.950
Rregullimi i parkut pran shkollës fillore "Svetis Sava"	9.947
Rregullimi i parkut në oborrin e shkollës,,Gjon Sereqi" në fshatin Mogillë	9.930
Asfaltimi i rrugëve në Klllokot (dy faza)	100.094
Pastrimi dhe rregullimi i shtratit të lumit,"Morava e Vjetër" dhe rregullimi i dy urave në Klllokot	41.154
Rregullimi i fushës sportive ne fshatin Mogillë	9.928
Ndërtimi i trotuareve në Klllokot	49.599
Kanalizimi i ujërave fekale - Gernqa	95.200
Rregullimi i rrjetit te kanalizimit në pjesën urbane te Klllokotit	186.619
Asfaltimi i rrugës Mogille-Verbovc	717.610

Për rregullimin e fushës së sportit në fshatin Mogillë, Komuna e Klllokotit ka shpallur dy herë tender për kryerjen e punëve të njëjta. Kësisoj tenderi i parë i shpallur i është dhënë kompanisë “Euro Trans” nga Kaçaniku me datë 08.03.2011 në vlerë prej 9.928 eurove. Ndërsa kontrata e dytë e lidhur nga Komuna e Klllokotit për rregullimin e fushës së sportit në fshatin Mogill i është dhënë kompanisë “Strassen” nga Ferizaj me datë 15.05.2012 në vlerë të kontratës 12.797,15 euro.

Në kohën kur Komuna e Klllokotit ka qenë pjesë administrative e Komunës së Vitisë, kjo komunë (Vitia) pati lejuar “Banjën e Klllokotit” që të nis ndërtimin e objektit gjigant në tokën e cila menaxhohet nga AKP (Agjencia Kosovare e Privatizimit). AKP pati ushtruar në atë kohë ankesë dhe kërkesë në MAPL për të anuluar vendimin e Komunës së Vitisë, gjë të cilën e ka bërë MAPL dhe menjëherë pas kësaj punët ishin ndërprerë. Pas formimit të Komunës së Klllokotit, njëri ndër vendimet e para të saj ka qenë lejimi i përgjegjëseve të “Banjës së Klllokotit” që ajo të vazhdojë ndërtimin në tokën e cila menaxhohet nga AKP. Serish MAPL ka nxjerr vendim që punët të ndërpriten, por kjo në praktik nuk është përfillur as nga përgjegjësit e Komunës së Klllokotit dhe as nga ana përgjegjëseve të “Banjës së Klllokotit”.

C.5. Aktivitetet e prokurimit publik 2010-2011

Njësia e Prokurimit në Komunën e Klllokotit, sipas organogramit të administratës së komunës, funksionon si organ në linjën horizontale ngjashëm si drejtoritë. Zyra e Prokurimit përbehet nga dy persona.

Për dy vite (2010-2011) Komuna e Klllokotit ka lidhur nëpërmjet procedurave të prokurimit 45 kontrata në vlerë të përgjithshme afro 1.5 milionë euro.

Tab. nr.16: Kontratat e Prokurimit në Komunën Klllokotit
2010-2011

Viti	Nr. i kontratave	Vlera e kontratave (Euro)
2010	27	1.215.353.49
2011	18	210.165.74
Total	45	1.425.192.3

Burimi: KRPP Raporti për 2010 dhe 2011

Komuna e Klllokotit me datë 25.05.2011 i ka dhënë kontratë kompanisë NTSH “Sporti” për blerjen e disa topave të futbollit dhe pajisjeve tjera sportive në vlere të kontratës 9.980 euro.

Komuna e Klllokotit me datë 27.06.2010 ka blerë telefona mobil për stafin udhëheqës të komunës në vlerë prej 3.450 eurove. Telefonat janë blerë nga firma e Podujevës

“Teleshop Ylli”. Këta telefona janë blerë për stafin udhëheqës të komunës (ekzekutivin), i cili numëron 11 persona: drejtorët, kryetari, nënkryetari, si dhe udhëheqësit e njësive.

Po ashtu në tabelën e mësipërme për investimet kapitale vërehet se një pjesë e madhe e investimeve kapitale kanë vlerën më pak se 10.000 euro. Kjo ndodhë ngasë në vlerat nën 10.000 euro nuk kërkohet shpallje e tenderit, por vetëm dërgimi i ofertave në së paku tre operator dhe i mbetet komunës që të përzgjedh ofertën më të përshtatshme. Kjo praktik sipas normave të prokurimit preferohet në rastet e linjës së mallrave dhe shërbimeve, por jo edhe në rastin e investimeve kapitale.

Raporti i Auditorit të Përgjithshëm i cili i referohet vitit 2010 nxjerr konstatim se rregullat e prokurimit publik në Komunën e Klllokotit në shume raste nuk janë përfillur, gjë kjo e cila sipas Auditorit lë të hapur mundësinë për keqpërdorimin e parësive publike.

Parregullsi në këtë komunë Auditori ka gjetur edhe gjatë procesit të auditimit të 26 aktivitete të prokurimit, në vlerë prej 1 milionë e 157 mijë euro. Sipas Auditorit, Komuna e Klllokotit gjatë 2010 ka përgatitur planin e prokurimit, por nuk e kishte dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik.

Po ashtu, në këtë komunë është vërejtur edhe shpërblimi i operatorëve ekonomik në mungesë të tre ofertuesve të përgjegjshëm. “Për kontratat ‘Programi softuerik për kontabilitet’ dhe ‘Furnizim me Diesel’ është vërejtur se janë shpërblyer kompanitë fituese në mungesë të tre ofertuesve të përgjegjshëm, duke mos i respektuar kriteret e vendosura në dosjen e tenderit”. Auditori Përgjithshëm i Kosovës, parregullsi ka evidentuar edhe të certifikimi i pagesave. Në raportin e tij, ai ka konstatuar se tetë pagesa kanë qenë të certifikuara në mënyrë të parregullt. “Mungon aprovimi nga ana e zyrtarit pranues, si dhe faturat janë prezantuar në formë të përgjithshme, pa u specifikuar se çka përmban fatura. Dështimet në zbatimin e rregullave të prokurimit kanë mundur të ekspozojnë komunën para rrezikut që fondet publike të jenë shpenzuar në mënyrë jo efektive dhe jo efikase. Certifikimi i lëndëve të pakompletuara dhe anashkalimi i procedurave nga zyrtari certifikues rrit rrezikun që të ndodhin pagesa të jashtëligjshme”.

C.6. Arsimi dhe Shëndetësia

Ngjashëm si te rasti i Graçanicës dhe Ranillugut, edhe në Komunën e Klllokotit sistemi arsimor dhe ai shëndetësor kryesisht kontrollohen dhe menaxhohen nga strukturat paralele të cilat struktura direkt ndikohen nga Qeveria e Serbisë. Në Klllokot ekzistojnë dy ambulanca, njëra tani ka nisur të ushtrojë funksionin e QKMF. Ekziston vetëm një mjek specialist dhe katër motra medicinale, ndërsa i tërë stafi mjekësor janë 15 veta.

Sistemi shëndetësor në Komunën e Kllokotit përbehet nga tri shkolla fillore, njëra nga to është etnikisht e përzier “Gjon Sereqi” në Mogillë. Në këto tri shkolla mësimin e mbajnë rreth 1.400 nxënës me rreth 55 mësime të mëdha.

C.7. Transparenca

Në Komunën e Kllokotit nuk ka zyrtar për informim. Në organogramin e këtij institucioni figuron Zyra për Informim, por në raportin e punës se vitit 2011 askund nuk përmendet kjo zyre dhe aktivitetet eventuale të saj.

Në faqen zyrtare të komunës hasen dokumentet dhe të dhënat elementare në lidhje me komunën dhe zhvillimet e përgjithshme, sidomos aktivitete dhe agjenda e Zyrës së Kryetarit.

Në Kllokot ekziston një radio lokale e quajtur Radio “Kllokoti” e cila përgjithësisht mundohet t’i transmetoj zhvillimet komunale. Kjo radio akoma nuk transmeton program edhe në gjuhën shqipe, i gjithë programi transmetohet vetëm në gjuhën serbe.

Tab. nr.17: Vlerësim i përmbajtjes së uebfaqes së Komunës së Kllokotit
<http://kk.rks-gov.net/kllokoti/>

Dokumenti	2010				2011				2012
	I	II	II I	IV	I	II	III	IV	I
Raporti i Punës së Kryetarit	x	x	x	x	x	√	x	x	x
Raporti financiar (buxhetor) i Komunës	x	x	x	√	x	x	√	√	√
Raportet e Drejtorisë së Administratës	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Arsimit	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mir.Sociale	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Inspektionit	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Financa, Ekonomi dhe Zhvillim	x	x	x	x	x	x	√	x	x
Urbaniz., Kadast. dhe Mb.Mjedisit	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Shërbimet Publike	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim	x	x	x	x	x	x	x	x	x

Rural									
Raportet dhe njoftimet e Zyrës së Prokurorit	Nuk ka asnjë publikim të kësaj natyre.								
Raportet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm	X								
Procesverbalet e Kuvendit Komunal	√					√			√
Rregulloret Komunale	Të gjitha rregulloret janë të publikuara.								
Vendimet e Kuvendit Komunal	√					√			√
Rregullorja e Punës së Kuvendit Komunal	√								
Procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Financa	√	√	√	√	√	√	√	√	√
Planet dhe Strategjitë e Komunës	x								

X = mungon raporti.

√= raporti është i publikuar në ueb-faqe

C.8. Ecuria e përmbushjes se premtimeve të fushatës zgjedhore 2009

Kandidati për kryetar komune, tani Kryetari i Komunës z. Sasha Mirkoviq, elektoratit të tij u ka dhënë 7 premtime.

Tabela më poshtë mat progresin e arritur në realizueshmërinë e premtimeve të dhëna në 2009. Në këtë tabelë janë përfshirë 7 premtime të dhëna. Në bazë të

hulumtimit të GAP del se pas dy viteve të qeverisjes në komunën e Graçanicës, apo gjysmën e mandatit qeverisës, 3 premtime janë përmbushur, 3 te tjera nuk ka pasur nisma konkrete për realizueshmërinë e tyre, ndërsa 1 ka pasur rrjedhë progresive, por akoma nuk mund të vlerësohet e përmbyllur.

Tab. nr.15: Premtimet 2009 nga Sasha Mirkoviq dhe realizueshmëria e tyre në 2010-2011

Premtimet	Realizueshmëria
Rregullimin e infrastrukturës në qytet dhe te fshatra	Ka pasur investime inkurajuese në këtë fushë, por projektet me të mëdha të realizuara janë përkrahur nga ministritë e linjës së Qeverisë së Kosovës. Kësisoj rruga me e shtrenjtë dhe me e gjatë e rregulluar ka qenë ajo që lidh fshatrat Mogillë-Verbovc me një kosto prej rreth 700 mijë euro, para të dhëna nga Qeveria e Kosovës. Po ashtu janë shtruar pjesa dërrmues e rrugëve në Kllokot, së bashku me rregullimin dhe zgjerimin e ndriçimit publik. Janë rregulluar në 16 vende të ndryshme trotuaret për këmbësor. Është rregulluar dhe pastruar shtrati i lumit në vendin e quajtur “Morava e vjetër” si dhe është bërë rregullimi i dy urave mbi këtë lum.
Ndërtimin e sistemit të kanalizim dhe rrjetit të ujësjellësit	Në rrjetin e ujësjellësit nuk ka pasur asnjë investim. Në rrjetin e kanalizimit janë realizuar dy projekte, njeri në fshatin Gerçar dhe rrjeti i kanalizimit në Kllokot.
Asfaltimin e rrugëve lokale dhe mirëmbajtjen e ambientit	Asfaltimi i rrugëve ka pasur ecuri të kënaqshme, ndërsa mirëmbajtja e ambientit mund të vlerësohet e mirë. Mirëmbajtja e

	<p>ambientit dhe investimet në këtë fushë janë bërë kryesisht në oborret e shkollave dhe përreth tyre. Kështu ka pasur investime në oborrin e shkollës së quajtur “Stevi Sava”, “Marko Jankoviç”, në shkollën “Gjon Sereqi”, etj.</p>
Largimin e mbeturinave	<p>Mbeturinat nga Kllokoti i tërheq kompania rajonale me seli në Gjilan, me të cilën Komuna e Kllokotit ka një kontratë. Kompania rajonale nuk është treguar efikase në grumbullimin e mbeturinave dhe zyrtarët komunal nuk janë të këndur me punën e kësaj kompanie.</p>
Banimin e sigurt dhe të drejtë për të gjithë qytetarët, duke përfshirë serbët, shqiptarët dhe romët	<p>Progres mund të merret formimi i stacionit policor në Kllokot. Komuna nuk e ka të formuar Këshillin Komunal për Siguri i cili do t'i diskutonte problemet në sferën e sigurisë si dhe gjetjen e formave për forcimin e sigurisë për banorët. Nuk është evidentuar ndonjë incident ndër-etnik, apo shkallë e lartë krimeve ordinere në këtë lokalitet.</p>
Zvogëlimin e problemit të furnizimit me energji elektrike dhe ngritjen e vetëdijesimit të qytetarëve për pagesën e saj.	<p>Asnjëra nuk është bërë. Kllokoti vazhdon të ballafaqohet me reduktime të gjata dhe të ashpra të energjisë elektrike.</p>
Uljen e papunësisë (punësimin e një anëtari nga çdo familje, qoftë në komunë apondërmarrje tjera	<p>Pjesa dërmues e të punësuarve në Banjën e Kllokotit dhe atë “Nëna Naile” vijnë me autobus nga Prishtina, Vushtrria, Ferizaj, Kaçaniku. Një numër krejt i vogël i të punësuarve në këto dy kompani të njohura vijnë nga Kllokoti. Komuna nuk ka ndërmarr asnjë hap apo nismë e cila do të rregullonte çështjen e punësimit. Komuniteti serb zakonisht punësohet në Mitrovicën e Veriut apo edhe në Serbi, ndërsa shqiptarët në Gjilan, Prishtinë apo Viti. Numri më i madh i të punësuarve në Kllokot është në sistemin e arsimit dhe atë të shëndetësisë, staf ky kryesisht i komunitetit serb, i cili tërheq paga edhe nga buxheti i Kosovës, por edhe nga Qeveria e Serbisë, përmes strukturave paralele.</p>

D. Letërnjoftimi i Komunës së Parteshit 2012

D.1. Hyrje

Komuna e Parteshit përbëhet nga tri zona kadastrale, me popullsi me shumicë serbe, që më parë ndodhej në territorin e Komunës së Gjilanit. Komuna e Parteshit shtrihet në pjesën lindore të Kosovës, me një sipërfaqe prej 28.66 km katrorë dhe me popullsi prej 5.100 banorësh.

Kryetari i Komunës së Parteshit është Nenad Svetković i cili ka përfaqësuar në zgjedhjet e fundit lokale subjektin politik "Zavicaj" i cili ka fituar gjashtë vende në Kuvendin Komunal, pasuar nga Lista e Bashkuar Serbe e cila ka marrë 3 vende, Iniciativa Qytetare Serbe me 3 vende, dy vende i ka Partia e Serbëve të Kosovës dhe Metohisë dhe me një vend është e përfaqësuar nga Partia Demokratike Serbe. Në total Kuvendi Komunal i Parteshit ka 15 ulëse.

Komuna e Parteshit është formuar pas decentralizimit në vend, kornizat e të cilit proces kanë qenë të parapara brenda të ashtuquajturës Pako e Ahtisaarit. Komuna e Parteshit është themeluar me 19 Gusht 2010 pas zgjedhjeve lokale të cilat janë mbajtur me 18 qershor 2010.

D.2. Performanca buxhetore e Komunës së Parteshit

Komuna e Parteshit ndonëse e themeluar në gjysmën e parë të vitit 2010, gjatë atij viti nuk ka themeluar mekanizmat për vjeljen e të hyrave komunale, kështu gjatë vitit 2010 Komuna e Parteshit nuk ka pasur të hyra. Shkalla e realizimit të hyrave një vit me vonë ka qenë tejet simbolike, përkatësisht gjithsej janë realizuar të hyra në vlerë prej 13.832 euro. Kjo shumë e të hyrave është për shumëfish më e vogël se sa shuma e shpenzuar e Komunës për telefona gjatë 2011.

Planifikimi i të hyrave për vitin 2012 nga Komuna e Parteshit sillet rreth 20.000 euro. Ky planifikim për të rritur të hyrat në planin e buxhetit thuhet se do të vije pas nisjes së lëshimit të lejeve të ndërtimit dhe pëlqimeve urbanistike, por deri në gjysmën e dytë të këtij viti (2012) komuna e Parteshit nuk ka nisur së lëshuari leje ndërtimi dhe akoma nuk ka nisur hartimin e asnjë plani rregullues mbi bazë të cilit do të mund të lëshonte pëlqime urbanistike nga e cila ka planifikuar të hyra.

Komuna e Parteshit gjatë vitit 2011 ka pasur gjithsej buxhet në vlerë prej 905.454 eurove. Prej tyre, për paga kanë qenë të dedikuara 578.531 euro, për mallra dhe shërbime 83.430

euro, shpenzime komunale 10.000 euro, subvencion dhe transfer 5.100 euro dhe për investime kapitale 228.306 euro.

Komuna e Parteshit gjatë vitit 2011 për udhëtime ka shpenzuar 6.381 euro. Për telefona 14.721 euro. Për derivate 20.091 euro. Ndërsa për shpenzimet e reprezentacionit (dreka zyrtare) 4.554 euro.

Komuna e Parteshit po ashtu ka hyrë në borxh në vlerë prej 232.758 euro, pjesa dërrmuese e borxhit është për linjën e mallrave dhe shërbimeve që sipas raporteve financiare të komunës borxhi ka ardhur nga mungesa e mjeteve financiare dhe aktualisht nuk dihet se si komuna do të arrijë t'i shlyej këto borxhe.

Sipas Auditorit të Përgjithshëm, Komuna e Parteshit nuk mban regjistra për shumicën e mallrave dhe shërbimeve të kontraktura nga ky institucion gjë kjo e cila sipas Auditorit rrit mundësinë për keqpërdorimin e parasë publike dhe pamundësinë e Auditorit për të nxjerr të dhëna të sakta dhe të plota në lidhje me shpenzimet.

Komuna e Parteshit për katër shkolla dhe një QMF kaq sa ekzistojnë në territorin e saj në 2011 ka blerë dru për ngrohje në vlerë prej 9.800 eurove. Kontrata është lidhur me firmën "Dardania" me datë 08.12.2011.

Komuna e Parteshit ka kryer procedurat e prokurimit për blerjen e veturave për nevojat e komunës, ndërsa paratë janë dhenë nga Qeveria. Janë blerë 4 vetura të tipit "Hyundai" në vlerë të përgjithshme 97.930.00 euro. Për një veturë i bije që janë shpenzuar 24.450 euro. Vetura të ngjashme ka blerë edhe Komuna e Prishtinës në fund të 2011 në vlerë për veturë afro 11.000 euro. Kontrata për blerjen e veturave është nënshkruar nga Komuna e Parteshit me datë 02.12.2010. Sipas raportit financiar të Komunës së Parteshit, pjesa më e madhe parave për blerjen e këtyre veturave akoma mbetet e figuruar si borxh i komunës.

D.3. Investimet kapitale

Investimet kapitale në Komunën e Parteshit janë të pakta dhe kjo vije në radhë të parë nga shuma tejet e vogël e mjeteve financiare në dispozicion për linjën e investimeve kapitale të cilat nuk kalojnë shifrën 250.000 euro në vit.

Pjesa më e madhe e investimeve në zonat e Parteshit ka ardhur nga Qeveria e Kosovës dhe ana e donatorëve ndërkombëtar.

Tab. nr.17: Investimet kapitale 2010-2011 në Komunën e Parteshit

Projektet kryesore të realizuara gjatë 2010 -2011	Shuma (Euro)
Ndërtimi i katit shtesë i qendres spitalore në fshatin Pasjan	227.894
Ndërtimi i Qendrës Rajonale të Kulturës në fshatin Pasjan	899.877
Ndriçimi i rrugës - Partesh, Pasjan dhe Budrigë e Poshtme	47.250
Sinjalizimi rrugor horizontal dhe vertikal – Partesh, Pasjan dhe Budrigë e Poshtme	14.700
Fusha e sporteve” Ballon” në Pasjan	-

Investimet kapitale kryesisht bëhen pa rregulla të qarta të prokurimit dhe mbetet e paqartë mënyra e përzgjedhjes së kompanive punëkryese. Nëse shikohen tabelat e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), atëherë vërehet se gjatë këtyre viteve në këtë komision nga Komuna e Parteshit kanë shkuar vetëm 7 njoftime për lidhje të kontratave nëpërmjet formës së prokurimit publik, numër ky shumëfish me i vogël se sa numri i projekteve të implementuara në atë lokalitet.

Po ashtu vlerësimi i 7 njoftimeve të dërguara nga Komuna e Parteshit në KRPP rezulton se 70 % e tyre kanë të bëjnë me mallra dhe shërbime dhe jo me investime kapitale.

Disa investime kapitale të proklamuar nga Qeveria e Kosovës për Komunën e Parteshit kanë rezultuar të jenë projekte jo mirë të menaxhuara. Kësisoj mbi 350.000 euro ka kushtuar rregullimi i shtratit të lumit në vijën Partesh- Budrig e Ulët, me gjatësi afro 320 metra dhe gjerësi të lumit 1.2 metra i shtruar në gurë si dhe është bërë rregullimi i anësoreve të lumit në gjerësi 2.4 metra. Komuna e Parteshit i ka kryer vetë procedurat e prokurimit, ndërkaq paratë janë dhënë nga Qeveria e Kosovës. Tenderin për rregullimin e këtij lumi e ka marr firma nga Skenderaj “Graniti”. Sipas informative të sigururra gjatë hulumtimeve në këtë Komunë, përzgjedhja e kësaj kompanie ka ardhur pas presioneve politike në adrese të Komunës së Parteshit të cilat presione kanë kërkuar që kompania nga Skenderaj të përzgjidhet si fitues për ndërtimin apo rregullimin e shtratit të lumit.

Auditori i Përgjithshëm në raportin e fundit të auditimit për Komunë të Parteshit (korrik 2011) ka konstatuar se paratë për rregullimin e lumit Partesh-Budrig e Ulët në vlerë mbi 350.000 eurove është kryer si transaksion komplet pas 25 ditëve të lidhjes së kontratës. Auditori në këtë rast përdor termin kontratë e dyshimtë.

Zyrtarët e Komunës së Parteshit thonë të kenë bërë një vlerësim për materialin e përdorur në lum si dhe për gjatësinë dhe gjerësinë e rregullimit i cili vlerësim ka rezultuar se e gjithë puna do të mund të kryhej me afro 70 mijë euro.

Puna në rregullimin e këtij shtratit të lumit është bërë pa pasur asnjë projekt teknik për ecurinë e punës dhe materialin që do të duhet përdorur. E gjithë kjo është lenë të zgjidhet nga vetë kryerësi i punëve.

Rasti i lumit Partesh-Budrig e Ulët është duke u hetuar edhe nga Policia e Kosovës dhe Agjencia Kundër Korrupsion. Policia ka intervistuar disa zyrtar komunal në lidhje me këtë projekt dhe ka bërë incizime në terren.

D.4. Aktivitetet e prokurimit publik 2010-2011

Njësia e Prokurimit në Komunën e Parteshit, sipas organogramit të administratës së komunës, funksionon si organ në linjën horizontale ngjashëm si drejtoritë. Zyra e Prokurimit aktualisht përbehet nga një person.

Për dy vite (2010-2011) Komuna e Parteshit ka lidhur nëpërmjet procedurave të prokurimit 24 kontrata në vlerë të përgjithshme afro 1.7 milionë euro.

Tab. nr.18: Kontratat e Prokurimit në Komunën Parteshit
2010-2011

Viti	Nr. i kontratave	Vlera e kontratave (Euro)
2010	11	542.115.54
2011	13	1.203.038.02
Totali	24	1.745.153.56

Burimi: KRPP Raporti për 2010 dhe 2011

Gjatë gjithë vitit 2010 zyrtari i Prokurimit Enlirat Kallaba ka punuar shef i Prokurimit në tri komuna (Partesh, Ranilluk dhe Kllokot). Kallaba nuk është duke punuar tani në asnjërën komunë, por pas vete ka lënë borxhe dhe shpenzime të mëdha komunale, si dhe dyshime për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Vetëm në Komunë të Parteshit Enlirat Kallaba ka lënë borxh për telefonin mobil mbi 2.100 euro, të cilat mjete aktualisht Komuna e Parteshit nuk i ka paguar PTK-së dhe refuzon ta bëjë një gjë të tillë.

Sipas Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për 2011, në aktivitetin e prokurimit për ofrim të ndihmës sociale në ushqime dhe pajisje higjienike për qytetarët e Komunës së Parteshit, Komuna e Parteshit ka bërë lëshime dhe parregullsi të mëdha. Sipas Auditorit Komuna e Parteshit nuk ka pasur ndonjë marrëveshje apo vendim lidhur me ofrimin e ndihmës sociale dhe rrjedhimisht nga kjo kanë munguar kriteret se kush mund të fitojë

kush jo ndihmë nga komuna. Përfituese kanë dal 59 familje të ndihmës sociale në vlerë 8.968 eurove. Auditori nuk ka gjetur se komuna ka ndonjë listë me emrat e përfituesve si dhe dëshmi lidhur me shpërndarjen e ndihmës sociale.

D.5. Administra në Komunën e Parteshit

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në Komunën e Parteshit është 86, prej tyre 46 të punësuar në komunë, 32 në arsimë dhe 8 në shëndetësi. Komuna posedon 6 drejtori komunale dhe tri zyre apo sektor.

Stafi politik dhe shërbyesit civil punojnë sipas tekeve dhe dëshirave personale. Nuk ka rregull, disiplinë, përgjegjësi dhe llogaridhënie për vendin e punës dhe as për orarin zyrtar të punës. Veturat zyrtare (gjashtë të tilla) përdoren pa kriter dhe zakonisht shfrytëzohen për distanca të largëta, jashtë territorit të komunës.

Ka raste kur zyrtaret komunal figurojnë të punësuar në komunë, por ushtrojnë veprimtari private jashtë komunës gjatë orarit të punës.

Komuna e Parteshit ka pranuar në punë Nebojsa Keniq në pozitën e mbikëqyrësit të punëve në terren. Nebojsa Keniq ka qenë nënkryetar i Komunës së Ranillugut dhe është larguar nga kjo detyrë nga Kryetari i Ranilukut me dyshimin se ka keqpërdor detyrën zyrtare.

D.6. Arsimi dhe Shëndetësia

Në territorin e Komunës së Parteshit gjenden dy shkolla, njëra fillore dhe tjetra e mesme, aktualisht në dy këto shkolla mësimin e zhvillojnë rreth 1.000 nxënës. Po ashtu në këtë komunë me herët ka ekzistuar vetëm një ambulant apo punkt shëndetësor, që tani Komuna e Parteshit i ka dhënë epitetin e QMF, ku punojnë 8 persona, ndërsa në sistemin arsimor janë të angazhuar 32 mësime.

Komuna e Parteshit në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës në vitin 2011 ka nisur ndërtimin e spitalit të qytetit dhe në inaugurimin e punimeve Kryetari i Komunës vendimin për ndërtimin e këtij spitali e ka arsyetuar me mungesën e mjekëve serb në spitalin rajonal të Gjilanit.

D.7. Transparenca

Autoritetet e Komunës së Parteshit nuk e kanë parë me prioritet asnjëherë çështjen e transparencës komunale. Në organogramin e këtij institucioni askund nuk haset e themeluar Zyra për Informim, apo ndonjë person ose departament që është përgjegjës për ushtrimin e këtij funksioni. Përveç kësaj informatat që dalin në faqen zyrtare të komunës përgjithësisht kanë të bëjnë me aktivitetet e zyrës së kryetarit dhe agjendën ditore të tij dhe askund nuk hasen dokumentet me rendësi për qytetarët. Asnjë rregullore, vendim, plan rregullues nuk haset në faqen zyrtare të komunës. Për vitet 2010 - 2011 nuk gjenden raportet e buxhetit, mbi shpenzimet komunale.

Tab. nr.19: Vlerësim i përmbajtjes së uebfaqes së Komunës së Partesh
<http://kk.rks-gov.net/partesh/>

Dokumenti	2010				2011				2012
	I	II	II I	IV	I	II	III	IV	I
Raporti i Punës së Kryetarit	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raporti financiar (buxhetor) i Komunës	x	x	x	x	x	x	x	√	√
Raportet e Drejtorisë së Administratës	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Arsimit	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mir.Sociale	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Inspektionit	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Financa, Ekonomi dhe Zhvillim	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Urbaniz., Kadast. dhe Mb.Mjedisit	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Shërbimet Publike	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet dhe njoftimet e Zyrës së Prokurorit	Nuk ka asnjë publikim te kësaj natyre.								
Raportet e Njësisë së Auditimit të Brendshëm	x								
Procesverbalet e Kuvendit Komunal	x				x				x

Rregulloret Komunale	Haset ne faqe rregullorja për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.								
Vendimet e Kuvendit Komunal	x			x			x		
Rregullorja e Punës së Kuvendit Komunal	x								
Procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Financa	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Planet dhe Strategjitë e Komunës	x								

X = mungon raporti.

√ = raporti është i publikuar ne ueb-faqe

Burimet:

A. Graçanicë

1. Agim Krasniqi - Nënkyetar i Komunes së Graçanicës
2. Isak Vorgallqiq – Drejtor i radios “Kim” në Graçanicë
3. Raporti financiar 2010 i Komunes së Graçanicës - <http://www.opstinagracanica.com/2010-10-31-15-42-03/category/1-statut-budzet-izvestaji.html>
4. Raporti financiar 2011 i Komunes së Graçanicës - <http://www.opstinagracanica.com/2010-10-31-15-42-03/category/1-statut-budzet-izvestaji.html>
5. Buxheti i Komunës së Graçanicës 2010 -2011-2012 - <http://www.opstinagracanica.com/2010-10-31-15-42-03/category/1-statut-budzet-izvestaji.html>
6. Rregulloret komuna të Komunes së Graçanicës -
7. Ueb faqja zyrtare e Komunes së Graçanicës - <http://www.opstinagracanica.com/>
8. Raporti Financiar 2010 dhe Raporti Financiar 2011 i Ministrise se Financave të Qeverisë së Kosovës - <http://mf.rks-gov.net/sq-al/ministriaefinancave/buxhetiirepublikesekosoves/buxhetiendrore.aspx>
9. Raporti vjetor 2010 – 2011 i Ministrise se Administrimit te Pushtetit Lokal - <http://www.mapl-ks.org/raporti> i komunave
10. Raporti i OSBE-së për Komunën e Graçanicës - <http://www.osce.org/kosovo/88762>
11. Njoftimet tabelore për lidhjen e kontratave përmes prokurimit publik nga Komuna e Graçanicës - http://krpp.rks.gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&stat=2&PPRCMenu_OpenNode=114
12. Raportet vjetore 2010 -2011 të Koomisionit Rregullativ të Prokurimit Publik - http://krpp.rks.gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PPRCMenu_OpenNode=64
13. Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik - oshp.rks-gov.net/

B. Ranillug

14. Raporti financiar 2010 i Komunes së Ranillugut - <http://kk.rks-gov.net/ranillug/Reguloret-dhe-Pasqyrat-Komunale.aspx>
15. Planet e Komunës së Ranillugut - <http://kk.rks-gov.net/ranillug/Reguloret-dhe-Pasqyrat-Komunale.aspx>
16. Holumtimi i opinionit të qytetareve të Ranillugut 2010 - http://emi-kosovortri.org/repository/docs/Ranillug_2010_ENG.pdf
17. Raporti Financiar 2010 dhe Raporti Financiar 2011 i Ministrise së Financave të Qeverisë së Kosovës - <http://mf.rks-gov.net/sq-al/ministriaefinancave/buxhetiirepublikesekosoves/buxhetiquirendrore.aspx>
18. Ueb faqja zyrtare e Komunës së Ranillugut - <http://kk.rks-gov.net/ranillug/Home.aspx>
19. Raporti vjetor 2010 – 2011 i Ministrise së Administrimit të Pushtetit Lokal - <http://www.mapl-ks.org/raporti> i komunave
20. Njoftimet tabelore për lidhjen e kontratave përmes prokurimit publik nga Komuna e Ranillugut - http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&stat=2&PPRCMenu_OpenNode=114
21. Raportet vjetore 2010 -2011 të Koomisionit Rregullativ të Prokurimit Publik - http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PPRCMenu_OpenNode=64
22. Raporti i OSBE-së për Komunën e Ranillugut - <http://www.osce.org/sq/kosovo/75451>
23. Vendimi i ICO-së për Komunën e Ranillugut - <http://www.ico-kos.org/?id=52>

C. Klllokot

24. Besim Arifi – Asamblistë i Kuvendit Komunal të Klllokotit nga radhët e LDK
25. Mustaf Emini – Menaxher i zyrës se Financave në Komunën e Klllokotit
26. Skender Hoda – Përgjegjes për administratë në Komunen e Klllokotit
27. Nebojsa Vasiq – Përgjegjes i radios lokale “Klllokoti”
28. Raporti financiar 2010 i Komunës së Klllokotit - <http://kk.rks-gov.net/klllokoti/?lang=sr-Latn-CS>
29. Raporti financiar 2011 i Komunës së Klllokotit - <http://kk.rks-gov.net/klllokoti/?lang=sr-Latn-CS>
30. Tabelat buxhetore te Komunës së Klllokotit - <http://kk.rks-gov.net/klllokoti/?lang=sr-Latn-CS>
31. Holumtimi i opinionit të qytetarëve te Komunës së Klllokotit - http://emi-kosovo-rti.org/repository/docs/Klllokot_2010_ENG.pdf
32. Raporti Financiar 2010 dhe Raporti Financiar 2011 i Ministrisë së Financave të Qeverisë së Kosovës - <http://mf.rks-gov.net/sq-al/ministriaefinancave/buxhetiirepublikesekosoves/buxhetiendrore.aspx>
33. Ueb faqja zyrtare e Komunes së Klllokotit - *k.rks-gov.net/klllokoti*
34. Raporti vjetor 2010 – 2011 i Ministrise se Administrimit të Pushtetit Lokal - <http://www.mapl-ks.org/raporti> i komunave
35. Njoftimet tabelore për lidhjen e kontratave përmes prokurimit publik nga Komuna e Klllokotit - http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&stat=2&PPRCMenu_OpenNode=114
36. Raportet vjetore 2010 -2011 të Koomisionit Rregullativ të Prokurimit Publik - http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PPRCMenu_OpenNode=64
37. Raporti i OSBE-së për Komunën e Klllokotit – [www.http://www.osce.org/kosovo/88759](http://www.osce.org/kosovo/88759)

D. Partesh

38. Remzi Sahiti – Përgjegjes për kataster dhe gjeodezi në Komunë të Parteshit
39. Sergjan Jordanoviç – Drejtor për Buxhet dhe Financa në Komunën e Parteshit
40. Shpalosja e pasqyrave financiare. Dokumenti është derguar nga Komuna e Parteshit në Institutin GAP
41. Buxheti i përgjithshëm i Komunes së Parteshit për vitin 2012 - Dokumenti është derguar nga Komuna e Parteshit në Institutin GAP
42. Holumtimi i opinionit të qytetarëve të Komunes së Parteshit - http://emi-kosovo-rti.org/repository/docs/Partesh_2010_ENG.pdf
43. Raporti Financiar 2010 dhe Raporti Financiar 2011 i Ministrise se Financave të Qeverisë së Kosovës - <http://mf.rks-gov.net/sq-al/ministriaefinancave/buxhetiirepublikesekosoves/buxhetiqendrore.aspx>
44. Raporti vjetor 2010 – 2011 i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal - <http://www.mapl-ks.org/raporti> i komunave
45. Ueb faqja zyrtare e Komunës së Parteshit - kk.rks-gov.net/partesh/
46. Njoftimet tabelore për lidhjen e kontratave përmes prokurimit publik nga Komuna e Parteshit - http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&stat=2&PPRCMenu_OpenNode=114
47. Raportet vjetore 2010 -2011 të Koomisionit Rregullativ të Prokurimit Publik - http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PPRCMenu_OpenNode=64
48. Raporti i OSBE-së për Komunën e Parteshit - http://www.ecmi-map.com/map/index.php?option=com_content&viww=category&layout=blog&id=78&Itemid=106&lang=sq